



www.qbz.gov.al

FLETORJA ZYRTARE E REPUBLIKËS SË SHQIPËRISË



Viti: 2024 – Numri: 95

Botim i Qendrës së Botimeve Zyrtare

Tiranë – E enjte, 6 qershor 2024

PËRMBAJTJA

	Faqe
Ligj nr. 77/2023, datë 2.5.2024	Për disa shtesa dhe ndryshime në ligjin nr. 113/2020, “Për shtetësinë”.... 10507
Ligj nr. 49/2024, datë 16.5.2024	Për ratifikimin e memorandumit të mirëkuptimit ndërmjet qeverisë së Republikës së Shqipërisë (Këshilli i Ministrave) dhe qeverisë së Shteteve të Bashkuara të Amerikës për programin e shkëmbimit akademik “ <i>Fulbright</i> ” 10508
Dekret i Presidentit nr. 207, datë 31.5.2024	Për shpallje ligji..... 10516
Ligj nr. 51/2024, datë 16.5.2024	Për ratifikimin e marrëveshjes për bashkëpunimin ekonomik ndërmjet Këshillit të Ministrave të Republikës së Shqipërisë dhe qeverisë së Republikës së Azerbajxhanit..... 10516
Dekret i Presidentit nr. 208, datë 31.5.2024	Për shpallje ligji..... 10523
Vendim i Kuvendit nr. 50/2024, datë 30.5.2024	Për ngritjen e Komisionit të Posaçëm, për Thellimin e Reformave për Mirëqeverisjen, Sundimin e Ligjit dhe Antikorrupsionin për Shqipërinë 2030 në Bashkimin Evropian..... 10523
Rezolutë e Kuvendit datë 30.5.2024	Për vlerësimin e veprimtarisë së Institutit të Studimeve për Krimet dhe Pasojat e Komunizmit në Shqipëri për vitin 2023..... 10525
Dekret i Presidentit nr. 212, datë 3.6.2024	Për lejimin e lënies së shtetësisë shqiptare..... 10526
Dekret i Presidentit nr. 213, datë 3.6.2024	Për dhënie të shtetësisë shqiptare 10526
Dekret i Presidentit nr. 214, datë 3.6.2024	Për dhënie të shtetësisë shqiptare 10527

Dekret i Presidentit nr. 215, datë 3.6.2024	Për dhënie të shtetësisë shqiptare	10527
Dekret i Presidentit nr. 216, datë 3.6.2024	Për dhënie të shtetësisë shqiptare	10527
Dekret i Presidentit nr. 217, datë 3.6.2024	Për dhënie të shtetësisë shqiptare	10528
Dekret i Presidentit nr. 218, datë 3.6.2024	Për dhënie të shtetësisë shqiptare	10528
Dekret i Presidentit nr. 219, datë 3.6.2024	Për dhënie të shtetësisë shqiptare	10528
Dekret i Presidentit nr. 220, datë 3.6.2024	Për dhënie të shtetësisë shqiptare	10529
Dekret i Presidentit nr. 221, datë 3.6.2024	Për dhënie të shtetësisë shqiptare	10529
Dekret i Presidentit nr. 222, datë 4.6.2024	Për dhënie të shtetësisë shqiptare	10529
Dekret i Presidentit nr. 223, datë 4.6.2024	Për dhënie të shtetësisë shqiptare	10529
Dekret i Presidentit nr. 224, datë 5.6.2024	Për dhënie të shtetësisë shqiptare.....	10530
Vendim i Këshillit të Ministrave nr. 331, datë 5.6.2024	Për lirim nga detyra.....	10530
Vendim i Këshillit të Ministrave nr. 332, datë 5.6.2024	Për emërim në detyrë.....	10530
Vendim i Këshillit të Ministrave nr. 333, datë 5.6.2024	Për emërim në detyrë	10530
Vendim i Këshillit të Ministrave nr. 334, datë 5.6.2024	Për lirim nga detyra të drejtorit të përgjithshëm të Tatimeve.....	10531
Vendim i Këshillit të Ministrave nr. 335, datë 5.6.2024	Për emërim në detyrë.....	10531

Vendim i Gjykatës Kushtetuese
nr. 37, datë 7.5.2024

Me objekt shfuqizimin e vendimit nr. 00-2023-2304, datë 6.6.2023,
të Kolegjit Administrativ të Gjykatës së Lartë, si të papajtueshëm me
Kushtetutën e Republikës së Shqipërisë.

Konstatimin e shkeljes së afatit të arsyeshëm të gjyimit të çështjes
administrative nr. 31155-00075-86-2022, me datë regjistrimi
19.1.2022, në Gjykatën Administrative të Apelit.

Detyrimin e Gjykatës Administrative të Apelit që të gjykojë çështjen
brenda një afati kohor të caktuar, sa më të afërt.....

10531

Kërkesë për shpalljen e vdekjes së shtetasit Fatmir Bruzja

10537



LIGJ
Nr. 77/2023

PËR DISA SHTESA DHE NDRYSHIME
NË LIGJIN NR. 113/2020,
“PËR SHTETËSINË”

Në mbështetje të neneve 81, pika 2, shkronja “b”, dhe 83, pika 1, të Kushtetutës, me propozimin e Këshillit të Ministrave,

KUVENDI
I REPUBLIKËS SË SHQIPËRISË

VENDOSI:

Në ligjin nr. 113/2020, “Për shtetësinë” bëhen këto shtesa dhe ndryshime:

Neni 1

Në nenin 7 pas pikës 2 shtohet pika 3 me këtë përmbajtje:

“3. Një fëmijë i lindur brenda territorit të Republikës së Shqipërisë nga prindër me shtetësi tjetër, të cilët qëndrojnë në mënyrë të ligjshme në territorin e Republikës së Shqipërisë, mund të marrë shtetësi shqiptare me pëlqimin e të dy prindërve.”.

Neni 2

Në nenin 8, “Fitimi i shtetësisë me natyralizim”, bëhen ndryshimet si më poshtë:

Pika 1, shkronja “e” ndryshon si më poshtë:

“e) zotëron njohuri të gjuhës shqipe, të folur dhe të shkruar, si dhe njohuritë bazë të historisë së Republikës së Shqipërisë, të vërtetuar nga institucioni përkatës arsimor. Përfundimisht nga ky rregull bëhet vetëm për shtetasit e huaj në shtetet e të cilave gjuha shqipe është gjuhë zyrtare.”.

Pika 3 ndryshon si më poshtë:

“3. I huaji, që është i martuar me shtetas shqiptar për një periudhë jo më pak se 3 (tre) vjet, mund të paraqesë kërkesë për të fituar shtetësinë me natyralizim edhe nëse nuk plotëson kushtet e përcaktuara në shkronjat “c” dhe “e” të pikës 1 të këtij neni, nëse ka banuar në mënyrë të ligjshme dhe të vazhdueshme në territorin e Republikës së Shqipërisë të paktën për 1 (një) vit gjatë gjithë periudhës së martesës.”.

Në pikën 4 pas fjalëve “në shkronjën “c”” shtohen fjalët “dhe “e””.

Neni 3

Në nenin 9, pika 1, togfjalëshi “që ka mbushur moshën 18 (tetëmbëdhjetë) vjeç” hiqet.

Neni 4

Në nenin 9 pas pikës 1 shtohet pika 1/1 me këtë përmbajtje:

“1/1. Për shtetasin e huaj që nuk ka mbushur moshën 18 vjeç, shtetësia shqiptare sipas pikës 1 të këtij neni mund të fitohet vetëm me pëlqimin e të dy prindërve ose kujdestarit ligjor, si dhe të fëmijës që ka moshën 14-18 vjeç.”.

Neni 5

Në nenin 11 të ligjit, “Fitimi i shtetësisë nga refugjatët apo nga personat në mbrojtje plotësuese”, bëhen ndryshimet si më poshtë:

Në pikën 1 shkronjat “dh” dhe “e” ndryshojnë si më poshtë:

“dh) nuk ka qenë i dënuar me vendim gjyqësor të formës së prerë në Republikën e Shqipërisë ose në ndonjë shtet të tretë për veprat penale për të cilat ligji shqiptar parashikon dënime me jo më pak se 3 (tre) vjet heqje lirie, me përjashtim të rasteve kur vërtetohet se dënimi është dhënë për motive politike.

e) zotëron njohuri të gjuhës shqipe, të folur e të shkruar, njohuritë bazë të historisë e të Kushtetutës së Republikës së Shqipërisë, të vërtetuar nga institucioni përkatës arsimor.”.

Neni 6

Në nenin 17 të ligjit, “Paraqitja e kërkesës”, bëhen ndryshimet si më poshtë:

Pika 1 ndryshon si më poshtë:

“1. Kërkesa drejtuar Presidentit të Republikës së Shqipërisë për fitimin, rifitimin dhe heqjen dorë nga shtetësia shqiptare dhe dokumentacioni i kërkuar sipas këtij ligji depozitohen online nëpërmjet platformës elektronike “e-albania”.”.

Pika 2 ndryshon si më poshtë:

“2. Rregullat e detajuara për dokumentacionin e nevojshëm, formën dhe mënyrën e plotësimit të



kërkesës sipas këtij neni, miratohen me udhëzim të përbashkët të ministrit përgjegjës për çështjet e rendit dhe sigurisë publike dhe ministrit përgjegjës për punët e jashtme.”.

Neni 7

Pas nenit 19 të ligjit shtohet neni 19/1 me këtë përmbajtje:

“Neni 19/1
E drejta për rishikim

Akti administrativ, i cili vendos mospranimin e kërkesës për fitimin, rifitimin apo heqjen dorë nga shtetësia shqiptare, mund të ankimohet pranë gjykatës administrative të shkallës së parë Tiranë në përputhje me legjislacionin përkatës në fuqi.”.

Neni 8
Nxjerrja e aktit nënligjor

Ngarkohet ministri përgjegjës për rendin dhe sigurinë publike, si dhe ministri përgjegjës për punët e jashtme që brenda 15 ditëve nga hyrja në fuqi e këtij ligji të miratojnë udhëzimin e përbashkët në zbatim të pikës 2 të nenit 17 të këtij ligji.

Neni 9
Hyrja në fuqi

Ky ligj hyn në fuqi 15 ditë pas botimit në Fletoren Zyrtare.

KRYETARE
Lindita Nikolla

Miraturar në datën 2.5.2024.

LIGJ

Nr. 49/2024

**PËR RATIFIKIMIN E
MEMORANDUMIT TË MIRËKUPTIMIT
NDËRMJET QEVERISË SË
REPUBLIKËS SË SHQIPËRISË
(KËSHILLI I MINISTRAVE) DHE
QEVERISË SË SHTETEVE TË
BASHKUARA TË AMERIKËS PËR
PROGRAMIN E SHKËMBIMIT
AKADEMIK “FULBRIGHT”**

Në mbështetje të neneve 78, 83, pika 1, dhe 121, pika 1, të Kushtetutës, me propozimin e Këshillit të Ministrave,

KUVENDI
I REPUBLIKËS SË SHQIPËRISË

VENDOSI:

Neni 1

Ratifikohet memorandumi i mirëkuptimit ndërmjet qeverisë së Republikës së Shqipërisë (Këshilli i Ministrave) dhe qeverisë së Shteteve të Bashkuara të Amerikës për programin e shkëmbimit akademik “*Fulbright*” sipas tekstit që i bashkëlidhet këtij ligji dhe është pjesë përbërëse e tij.

Neni 2

Ky ligj hyn në fuqi 15 ditë pas botimit në Fletoren Zyrtare.

Miraturar në datën 16.5.2024.

**Shpallur me dekretin nr. 207, datë 31.5.2024
të Presidentit të Republikës së Shqipërisë,
Bajram Begaj.**



**MEMORANDUM MIRËKUPTIMI
NDËRMJET QEVERISË SË REPUBLIKËS SË
SHQIPËRISË (KËSHILLI I MINISTRAVE)
DHE QEVERISË SË SHTETEVE TË
BASHKUARA TË AMERIKËS
PËR PROGRAMIN E SHKËMBIMIT
AKADEMIK “FULBRIGHT”**

Qeveria e Republikës së Shqipërisë (Këshilli i Ministrave) dhe Qeveria e Shteteve të Bashkuara të Amerikës (në vijim të referuar së bashku si “Pjesëmarrësit” dhe në njëjës referuar përkatësisht si “Pjesëmarrësi shqiptar” dhe “Pjesëmarrësi amerikan”);

me dëshirën për të zhvilluar bashkëpunimin ndërmjet institucioneve arsimore, shkencore dhe kërkimore të Republikës së Shqipërisë dhe atyre të Shteteve të Bashkuara të Amerikës, si dhe nxitjen e mirëkuptimit dhe miqësisë së ndërsjellë ndërmjet dy kombeve tona;

kanë arritur mirëkuptimin e mëposhtëm:

SEKSIONI 1

Qëllimi i këtij Memorandumi Mirëkuptimi (referuar në vijim si “MM”) është të forcojë dhe të zhvillojë lidhjet ndërmjet Pjesëmarrësve në procesin e zbatimit të Programit të Shkëmbimit Akademik *Fulbright* (referuar në vijim si “Programi *Fulbright*”) në arsim, kulturë, shkencë dhe punë kërkimore, bazuar në bashkëpunimin me përfitim të ndërsjellë.

SEKSIONI 2

Me pjesëmarrjen e tyre në Programin *Fulbright*, Pjesëmarrësit shpresojnë në nxitjen e bashkëpunimit ndërmjet institucioneve arsimore, shkencore dhe kërkimore të vendeve të tyre përkatëse dhe inkurajimin e përmirësimit të kualifikimeve të profesionistëve akademikë, studiuesve, pedagogëve dhe studentëve, si dhe nxitjen e projekteve të përbashkëta kërkimore-shkencore.

SEKSIONI 3

Koordinatori i këtij MM-je, në emër të pjesëmarrësit amerikan, është Seksioni për Marrëdhëniet me Publikun i Ambasadës së Shteteve të Bashkuara të Amerikës në Tiranë (në vijim i referuar si “PAS Tiranë”) dhe në emër të

Pjesëmarrësit shqiptar, është Ministria e Arsimit dhe Sportit (në vijim e referuar si “Ministria”).

SEKSIONI 4

Gjatë zbatimit të këtij MM-je, Pjesëmarrësi amerikan ka për qëllim të koordinojë si vijon: menaxhimin e Programit *Fulbright* në Republikën e Shqipërisë; organizimin e përzgjedhjes fillestare të kandidatëve për Programin *Fulbright*; zhvillimin e aktiviteteve mësimore dhe shkencore; si dhe analizën e potencialit për shkëmbime akademike shtesë.

Pjesëmarrësit kanë për qëllim që përzgjedhja e kandidatëve për Programin *Fulbright* të jetë e hapur dhe të kryhet në përputhje me kriteret e vendosura nga Bordi i Bursave të Huaja J. William Fulbright të Shteteve të Bashkuara, të cilat gjenden në adresën: <http://fulbright.state.gov/fsb/program-policies>. PAS Tiranë mund të vendosë kriteret më specifike, në përputhje me politikat e programit *Fulbright*, të cilat njoftohen publikisht në momentin që bëhet thirrja për aplikim.

SEKSIONI 5

A. Çdo vit, Pjesëmarrësi amerikan ka për qëllim të propozojë studentë, staf akademik dhe profesionistë nga institucionet e arsimit të lartë dhe institucionet e tjera të Republikës së Shqipërisë për të studiuar në universitetet e SHBA-së dhe të koordinojë pjesëmarrjen e studentëve, stafit akademik dhe profesionistëve të Shteteve të Bashkuara të Amerikës në studim, kërkim ose trajnime akademike në institucionet akademike apo institucionet e tjera të Republikës së Shqipërisë.

B. Pjesëmarrësi shqiptar ka për qëllim të delegojë një përfaqësues për të marrë pjesë në Komisionin Përzgjedhës të Ambasadës së Shteteve të Bashkuara në Tiranë për të zgjedhur studentët, stafin akademik dhe profesionistët që aplikojnë për Programin *Fulbright*.

SEKSIONI 6

Çdo vit, Pjesëmarrësi amerikan ka për qëllim të propozojë studentë nga Republika e Shqipërisë për të studiuar në universitetet e Shteteve të Bashkuara për periudha nga 12 (dymbëdhjetë) deri në 24 (njëzet e katër) muaj.



SEKSIONI 7

Çdo vit, Pjesëmarrësi amerikan ka për qëllim të propozojë staf akademik dhe profesionistë nga Republika e Shqipërisë për të dhënë leksione dhe/ose për të zhvilluar kërkime shkencore në universitetet dhe institucionet kërkimore të Shteteve të Bashkuara dhe të koordinojë punën kërkimore dhe/ose leksionet e personelit akademik nga Shtetet e Bashkuara të Amerikës në institucionet arsimore, institutet dhe qendrat ndërinstitucionale të kërkim-zhvillimit të Republikës së Shqipërisë për periudha kohore që variojnë nga 3 (tre) deri në 9 (nëntë) muaj.

SEKSIONI 8

Çdo vit, Pjesëmarrësi amerikan ka për qëllim të propozojë staf akademik dhe profesionistë nga Republika e Shqipërisë për të marrë pjesë në programe të zhvillimit profesional dhe programe të shkëmbimit në Shtetet e Bashkuara të Amerikës.

SEKSIONI 9

Pjesëmarrësi amerikan ka për qëllim të koordinojë financimin dhe zbatimin e Programit *Fulbright* në Republikën e Shqipërisë. Byroja për Çështjet e Arsimit dhe Kulturës e Departamentit Amerikan të Shtetit planifikon të financojë studimet, kostot e jetesës, kostot e udhëtimit dhe sigurimin shëndetësor për studentët, stafin akademik dhe profesionistët amerikanë që marrin pjesë në Programin *Fulbright* në Republikën e Shqipërisë.

SEKSIONI 10

A. Në bashkërendim me Pjesëmarrësin amerikan, Pjesëmarrësi shqiptar ka për qëllim të ofrojë mbështetjen financiare në shumën prej 165 600 (njëqind e gjashtëdhjetë e pesë mijë e gjashtëqind) dollarësh amerikanë në vit, për të mbështetur kostot e Programit *Fulbright* për Studentët, me qëllim krijimin e më shumë mundësive për studentët, stafin akademik dhe profesionistët që marrin pjesë në Programin *Fulbright*.

B. Pjesëmarrësi shqiptar ka për qëllim të fillojë dhënien e këtij kontributi në vjeshtën e vitit 2024 dhe ta vazhdojë deri në vitin akademik 2029–2030. Pjesëmarrësi shqiptar mund të konsiderojë

bashkëpunimin e mëtejshëm me Pjesëmarrësin amerikan nëpërmjet akordimit të burimeve shtesë për studentët shqiptarë në fushat me interes të veçantë për pjesëmarrësin shqiptar.

SEKSIONI 11

Në zbatimin e këtij MM-je, pjesëmarrësit planifikojnë të shkëmbejnë informacion rreth institucioneve arsimore, kulturore, shkencore dhe kërkimore në Programin *Fulbright* për t'u dhënë përparësi nevojave arsimore, kulturore, shkencore dhe kërkimore të këtyre institucioneve.

SEKSIONI 12

Në zbatimin e këtij MM-je, Pjesëmarrësi shqiptar ka për qëllim të inkurajojë institucionet qeveritare, arsimore, kulturore, shkencore dhe kërkimore që të krijojnë kushtet më të favorshme për zbatimin e Programit *Fulbright* në Republikën e Shqipërisë.

SEKSIONI 13

Pjesëmarrësi shqiptar ka për qëllim të koordinojë në kohë miratimin dhe lëshimin e dokumenteve ligjore të nevojshme për studentët, stafin akademik dhe profesionistët amerikanë, për të marrë pjesë në Programin *Fulbright* në Republikën e Shqipërisë.

SEKSIONI 14

Pjesëmarrësi shqiptar ka për qëllim të punojë me institucionet e tij arsimore, shkencore dhe kërkimore që pranojnë pjesëmarrës të Programit *Fulbright*, me synim mundësimin e hapësirave të duhura të punës dhe pajisjeve përkatëse të nevojshme për kërkimet akademike, vendosjen e këshilltarëve sipas nevojave, garantimin e aksesit në bibliotekat dhe arkivat e institucionit pritës dhe për të lejuar pjesëmarrësit e Programit *Fulbright* të marrin pjesë në programe, kurse, leksione dhe seminare të përzgjedhura.

SEKSIONI 15

Pjesëmarrësit kanë për qëllim që shkëmbimet akademike që parashikohen në këtë MM, të zbatohen në përputhje me kuadrin ligjor dhe rregullator përkatës, duke përfshirë dhe ato që lidhen me disponueshmërinë e fondeve.



SEKSIONI 16

Pjesëmarrësit kanë për qëllim të shkëmbejnë informacion rreth zbatimit të këtij MM-je.

SEKSIONI 17

Për zbatimin e këtij MM-je, Ministria ka për qëllim të nënshkruajë një Marrëveshje me Institutin për Edukimin Ndërkombëtar (në vijim “IIE”) në lidhje me modalitetet dhe procedurat e disbursimit të fondeve të parashikuara në seksionin 10 të këtij MM-je. IIE është përgjegjës për administrimin e të gjitha fondeve të Departamentit Amerikan të Shtetit për Programin *Fulbright* në Shqipëri.

SEKSIONI 18

A. Ky MM ka për qëllim të fillojë me nënshkrimin e tij nga Pjesëmarrësit dhe të vijojë për një periudhë 5-vjeçare (pesëvjeçare).

B. Ky MM mund të modifikohet me shkrim me vendim të ndërsjellë të të dy pjesëmarrësve.

C. Ky MM mund të ndërpritet në çdo kohë nga njëri pjesëmarrës, duke informuar pjesëmarrësin tjetër me shkrim. Pjesëmarrësi, i cili dëshiron të ndërpresë Memorandumin, duhet të përpiqet të njoftojë me shkrim pjesëmarrësin tjetër të paktën 12 (dymbëdhjetë) muaj para mbi qëllimin e tij për ndërprerjen.

Nënshkruar në, më datë2024, në dublikatë, në gjuhën angleze dhe shqipe. Pjesëmarrësit kanë për qëllim që teksti në gjuhën angleze të jetë versioni zyrtar i këtij MM-je.

Për Qeverinë e Republikës së Shqipërisë
(Këshillin e Ministrave)

Për Qeverinë e Shteteve të Bashkuara
të Amerikës

**MEMORANDUM OF UNDERSTANDING****BETWEEN****THE GOVERNMENT OF THE REPUBLIC OF ALBANIA****(COUNCIL OF MINISTERS)****AND****THE GOVERNMENT OF THE UNITED STATES OF AMERICA****ON THE FULBRIGHT ACADEMIC EXCHANGE PROGRAM**

The Government of the Republic of Albania (Council of Ministers) and the Government of the United States of America (hereinafter jointly referred to as “the Participants” and, in the singular, as “the Albanian Participant” and “the U.S. Participant”, respectively);

Seeking to develop cooperation between educational, scientific, and research institutions of the Republic of Albania and the United States of America, in addition to promoting mutual understanding and friendship between our two nations:

Have reached the following understanding:

SECTION 1

The purpose of this Memorandum of Understanding (hereinafter “this MOU”) is to strengthen and develop ties between the Participants in the process of implementing the Fulbright Academic Exchange Program (hereinafter “the Fulbright Program”) in education, culture, science and research, based on cooperation that is mutually beneficial.

SECTION 2

The Participants expect their participation in the Fulbright Program to stimulate cooperation between educational, scientific, and research institutions in their respective countries and to encourage improvement in the qualifications of academic professionals, scholars, educators and students as well as the promotion of joint scientific research projects.

SECTION 3

The coordinator of this MOU on behalf of the U.S. Participant is the Public Affairs Section of the Embassy of the United States of America in Tirana (hereinafter referred to as “PAS Tirana”) and, on behalf of the Albanian Participant, the Ministry of Education and Sports (hereinafter referred to as the “Ministry”).



SECTION 4

In carrying out this MOU, the U.S. Participant intends to coordinate the following: the management of the Fulbright Program in the Republic of Albania: the organization of the primary selection of candidates for the Fulbright Program: the development of teaching and scientific activities; and the analysis of the potential for additional academic exchanges.

The Participants intend the selection of candidates for the Fulbright Program to be open, based on merit, and conducted consistently with the criteria established by the J. William Fulbright Foreign Scholarship Board of the United States, which are available at: <http://fulbright.state.gov/fsb/program-policies>. PAS Tirana may set more specific criteria, in line with Fulbright Program policies, which are openly announced at the time of the call for applications.

SECTION 5

A. Each year, the U.S. Participant intends to nominate students, academic staff, and professionals from higher education institutions and other institutions of the Republic of Albania to study at U. S. universities and to coordinate the participation of students, academic staff, and professionals from the United States of America in study, research, or academic training in academic institutions or other institutions of the Republic of Albania.

B. The Albanian Participant intends to delegate one representative to participate in the Selection Committee at the United States Embassy in Tirana to select students, academic staff, and professionals applying for the Fulbright Program.

SECTION 6

Each year, the U.S. Participant intends to nominate students from the Republic of Albania to study at U.S. universities for a twelve (12) to twenty-four (24) month period.

SECTION 7

Each year, the U.S. Participant intends to nominate academic staff and professionals from the Republic of Albania to lecture and/or carry out scientific research at U.S. universities and research institutions and to coordinate the research and/or lectures by academic staff from the United States of America at educational institutions, institutes, and inter-institutional research and development centers of the Republic of Albania for time periods ranging from between three (3) and nine (9) months.

SECTION 8

Each year, the U.S. Participant intends to nominate academic staff and professionals from the Republic of Albania to participate in professional development programs and exchange programs in the United States of America.



SECTION 9

The U.S. Participant intends to coordinate the funding and implementation of the Fulbright Program in the Republic of Albania. The U.S. Department of State's Bureau of Educational and Cultural Affairs plans to fund studies, living allowances, travel costs, and health benefits for U.S. students, academic staff, and professionals participating in the Fulbright Program in the Republic of Albania.

SECTION 10

- A. In coordination with the U.S. Participant, the Albanian Participant intends to offer financial support in the amount of 165,600 (one hundred and sixty-five thousand six hundred) US dollars annually to support the costs of the Fulbright Student Program, in order to provide more opportunities for students, academic staff, and professionals participating in the Fulbright Program.
- B. The Albanian Participant intends to initiate this contribution in Fall 2024 and continue through academic year 2029-2030. The Albanian Participant may consider further cooperation with the U.S. Participant through allocation of additional resources for Albanian students in areas of particular interest to the Albanian Participant.

SECTION 11

In implementing this MOU, the Participants plan to exchange information on educational, cultural, scientific, and research institutions in the Fulbright Program to prioritize the educational, cultural, scientific, and research needs of these institutions.

SECTION 12

In implementing this MOU, the Albanian Participant intends to encourage governmental, educational, cultural, scientific, and research institutions to create the most favorable conditions for carrying out the Fulbright Program in the Republic of Albania.

SECTION 13

The Albanian Participant intends to coordinate timely approval and issuance of legal documents required for U.S. students, academic staff, and professionals to participate in the Fulbright Program in the Republic of Albania.

SECTION 14

The Albanian Participant intends to work with its educational, scientific, and research institutions receiving participants in the Fulbright Program with the intention of providing appropriate workspaces and relevant equipment required for academic research, the establishment of advisers as needed, access to libraries and archives of the host institution, and to allow Fulbright Program participants to attend selected programs, courses, lectures, and workshops.



SECTION 15

The Participants intend for the academic exchanges described in this MOU to be implemented in accordance with relevant legal and regulatory frameworks, including those related to the availability of funds.

SECTION 16

The Participants intend to exchange information on the implementation of this MOU.

SECTION 17

Upon implementation of this MOU, the Ministry intends to sign an agreement with the Institute of International Education (hereinafter “IIE”), regarding the modalities and procedures for the disbursement of funds contemplated in Section 10 of this MOU. IIE is in charge of administering all U.S. Department of State funds for the Fulbright Program in Albania.

SECTION 18

- A. This MOU is intended to commence upon the last signature of the Participants to continue for a period of five (5) years.
- B. This MOU may be modified in writing by the mutual decision of both Participants.
- C. This MOU may be discontinued by either Participant at any time by giving written notice to the other Participant. The discontinuing Participant should endeavor to provide the other Participant with at least twelve (12) months’ prior notice of its intent to discontinue.

Signed at, this..... day of..... 2024, in duplicate, in the English and Albanian languages. The Participants intend for the English language text to be the official version of this MOU.

For the Government of the Republic of Albania
(Council of Ministers)

For the Government
of the United States of America



DEKRET

Nr. 207, datë 31.5.2024

PËR SHPALLJE LIGJI

Në mbështetje të nenit 84, pika 1, dhe nenit 93 të Kushtetutës,

DEKRETOJ:

Shpalljen e ligjit nr. 49/2024, “Për ratifikimin e memorandumit të mirëkuptimit ndërmjet qeverisë së Republikës së Shqipërisë (Këshilli i Ministrave) dhe qeverisë së Shteteve të Bashkuara të Amerikës për programin e shkëmbimit akademik ‘Fulbright’”.

PRESIDENT I REPUBLIKËS
SË SHQIPËRISË
Bajram Begaj

LIGJ
Nr. 51/2024

**PËR RATIFIKIMIN E MARRËVESHJES
PËR BASHKËPUNIMIN EKONOMIK
NDËRMJET KËSHILLIT TË
MINISTRAVE TË REPUBLIKËS SË
SHQIPËRISË DHE QEVERISË SË
REPUBLIKËS SË AZERBAJXHANIT**

Në mbështetje të neneve 78, 83, pika 1, dhe 121, pika 1, të Kushtetutës, me propozimin e Këshillit të Ministrave,

KUVENDI
I REPUBLIKËS SË SHQIPËRISË

VENDOSI:

Neni 1

Ratifikohet marrëveshja për bashkëpunimin ekonomik ndërmjet Këshillit të Ministrave të Republikës së Shqipërisë dhe qeverisë së Republikës së Azerbajxhanit, sipas tekstit që i bashkëlidhet këtij ligji dhe është pjesë përbërëse e tij.

Neni 2

Ky ligj hyn në fuqi 15 ditë pas botimit në Fletoren Zyrtare.

Miratuar në datën 16.5.2024.

**Shpallur me dekretin nr. 208, datë 31.5.2024,
të Presidentit të Republikës së Shqipërisë,
Bajram Begaj.**

MARRËVESHJE

PËR BASHKËPUNIMIN EKONOMIK
NDËRMJET KËSHILLIT TË MINISTRAVE
TË REPUBLIKËS SË SHQIPËRISË DHE
QEVERISË SË REPUBLIKËS SË
AZERBAJXHANIT

Këshilli i Ministrave i Republikës së Shqipërisë (në vijim i referuar edhe si “QSH”) dhe qeveria e Republikës së Azerbajxhanit, në vijim të referuara bashkërisht si “Palët” dhe individualisht si “Palë”, “Shqipëri” ose “Azerbajxhan”;

duke konfirmuar se palët kanë marrëdhënie të gjata miqësore dhe të frytshme, dhe kërkojnë të forcojnë bashkëpunimin dypalësh në disa sektorë ekonomikë;

duke theksuar se palët synojnë, nëpërmjet kësaj marrëveshjeje për bashkëpunim ekonomik, që të përmirësojnë bashkëpunimin e tyre ekonomik;

duke theksuar gjithashtu se reformat e orientuara nga tregu dhe një kuadër i fortë investimi me stimuj të përshtatshëm dhe mbrojtje të qëndrueshme të investitorëve në projektet strategjike janë të dobishme për tërheqjen dhe mbështetjen e investimeve të huaja;

gjithashtu, duke ritheksuar rëndësinë e ruajtjes së standardeve të larta, në lidhje me shëndetin, sigurinë, mjedisin, punën, transparencën dhe qeverisjen e mirë për projektet dhe investimet;

kanë rënë dakord, për sa më poshtë:

Neni 1

Palët kanë interes të ndërsjellë në forcimin e lidhjeve ekonomike dhe promovimin e pjesëmarrjes reciproke tregtare, dhe për këtë arsye, do të inkurajojnë dhe nxisin bashkëpunimin ndërmjet dy vendeve, bazuar në parimet e miqësisë, respektit të plotë të sovranitetit, integritetit territorial dhe



paprekshmërisë së kufijve ndërkombëtarë të të dyja shteteve dhe interesave të përbashkëta, në përputhje me legjislacionet përkatëse kombëtare, të drejtën ndërkombëtare dhe dispozitat e kësaj marrëveshjeje.

Palët do të inkurajojnë veçanërisht bashkëpunimin ekonomik dhe tregtar, dhe partneritetet strategjike në sektorë dhe fusha specifike të interesit, mbi bazën e barazisë dhe përfitimeve të ndërsjella, në përputhje me termat dhe kushtet e përcaktuara në këtë marrëveshje dhe sipas termave dhe kushteve të përcaktuara në dokumentet e tjera, të lidhura për zbatimin e projekteve dhe programeve të parashikuara në projektet dhe sektorët prioritarë ndërmjet palëve dhe/ose ndërmjet njërës prej palëve dhe sektorit privat, ose ndërmjet sektorit privat të të dyja palëve, dhe/ose organeve ose autoriteteve kompetente të palëve që zbatojnë një projekt apo program konkret.

Palët pranojnë se sektorët dhe projektet kryesore prioritare të synuara për bashkëpunim brenda kuadrit të marrëveshjes përfshijnë, por nuk kufizohen në:

- a) tregti dhe investime;
- b) energji dhe miniera;
- c) transport dhe infrastrukturë;
- d) bujqësi;
- e) turizëm dhe mjedis;
- f) arsim dhe shkencë;
- g) kulturë.

Palët do të inkurajojnë bashkëpunim ndërmjet autoriteteve, subjekteve tregtare dhe subjekteve të tjera publike ose private të të dyja vendeve, si dhe përfshirjen e qytetarëve, në përputhje me legjislacionin kombëtar të palëve.

Neni 2

Palët do të ndjekin bashkëpunimin brenda objektit të kësaj marrëveshjeje dhe sipas legjislacioneve kombëtare, ekspertizës dhe përvojës në fushat e lartpërmendura.

Gjithashtu, palët marrin përsipër të ofrojnë njohuri/ekspertizë dhe të ndërtojnë platforma të bazuara në aftësi për përmirësimin dhe zhvillimin profesional në sektorët dhe projektet prioritare të dakordësuara, duke shkëmbyer praktikat më të mira dhe projekte konkrete, duke përfshirë por pa u kufizuar në energjinë, teknologjitë kritike dhe bujqësinë.

Neni 3

Asgjë në këtë marrëveshje nuk do t'i ndalojë palët të bashkëpunojnë në fusha të tjera që nuk mbulohen nga kjo marrëveshje.

Neni 4

Palët do të punojnë për zbatimin e kësaj marrëveshjeje nëpërmjet lidhjes së marrëveshjes/eve, memorandumëve të mirëkuptimit dhe protokolleve përkatëse ndërmjet sektorit publik dhe privat të të dyja palëve dhe intensifikimit të vizitave zyrtare ndërmjet zyrtarëve apo delegacioneve përkatëse.

Neni 5

Të gjitha masat e investimeve dhe bashkëpunimit të ndërsjellë që përfshihen në fushat e bashkëpunimit, në përputhje me neni 1 dhe nenin 2 të kësaj marrëveshjeje, do të dakordësohen dhe zbatohen sipas termave dhe kushteve të dakordësuara nga palët në këtë marrëveshje ose nga secila palë dhe sektori privat, ose sektori privat i të dyja palëve, të gjitha të rregulluara nga marrëveshje/kontrata të veçanta përkatëse dhe me procedura specifike që duhet të bien dakord palët në përputhje me rrethanat.

Neni 6

1. Palët do të krijojnë një Komision të Përbashkët Ndërqeveritar për të punuar mbi termat e mbuluara nga kjo marrëveshje ose çdo temë tjetër që do të bihet dakord ndërmjet palëve.

2. Kryetarët e Komisionit të përmendur në nenin 6(1) do të përcaktohen përmes kanaleve zyrtare të identifikuara nga palët pas hyrjes në fuqi të marrëveshjes.

3. Komisioni do të rekomandojë, për çështjet si më poshtë:

a) një rishikim të përgjithshëm të kësaj marrëveshjeje, me synim avancimin e objektivave të saj;

b) të diskutojë dhe shqyrtojë zbatimin dhe funksionimin e kësaj marrëveshjeje;

c) identifikimin e fushave apo projekteve konkrete të bashkëpunimit ndërmjet palëve;

d) vlerësimin e rezultateve të nxjerra nga zbatimi i kësaj marrëveshjeje dhe shqyrtimin e çdo çështjeje



tjetër që lidhet me interpretimin dhe zbatimin e kësaj marrëveshjeje.

4. Komisioni, me pëlqimin e ndërsjellë të palëve, mund të ftojë përfaqësues të subjekteve përkatëse, të ndryshme nga përfaqësuesit e palëve, me ekspertizën e nevojshme, në lidhje me çështjet që do të diskutohet dhe duhet të mbajë takime të përbashkëta me sektorët privatë.

5. Komisioni mund të krijojë komisione dhe nënkomisione, dhe t'u delegojë atyre detyra specifike.

6. Komisioni do të mbledhet periodikisht për të diskutuar dhe shqyrtuar progresin e bërë mbi çështjet e mësipërme në mënyrë të rregullt dhe për të identifikuar, dhe eksploruar masa të mëtejshme për të rritur bashkëpunimin e tyre dhe avancuar më tej marrëdhëniet ndërmjet shteteve.

7. Ministrinë kompetente të linjës të të dyja vendeve janë të autorizuar që të veprojnë si autoritete përkatëse të cilave u është besuar koordinimi, ndjekja dhe përgatitja për takimet e të dyja palëve dhe t'u raportojnë palëve mbi progresin.

Neni 7

Bashkëpunimi sipas kësaj marrëveshjeje nuk do të cenojë të drejtat dhe detyrimet e palëve, sipas traktateve të tjera ndërkombëtare në të cilat shtetet e tyre janë palë.

Neni 8

Çdo mosmarrëveshje që lind nga interpretimi ose zbatimi i kësaj marrëveshjeje do të zgjidhet me mirëkuptim nëpërmjet konsultimeve dhe negociatave ndërmjet të dyja palëve me kanale diplomatike.

Neni 9

Kjo marrëveshje mund të ndryshohet me pëlqimin e ndërsjellë me shkrim të palëve. Këto ndryshime do të bëhen në formën e protokolleve të veçanta që janë pjesë përbërëse e kësaj marrëveshjeje

dhe do të hyjnë në fuqi në përputhje me nenin 10 të kësaj marrëveshjeje.

Neni 10

Kjo marrëveshje lidhet për një periudhë të pacaktuara dhe do të hyjë në fuqi në datën e marrjes së njoftimit të fundit me shkrim nga palët, nëpërmjet kanaleve diplomatike, që konfirmon përfundimin e procedurave të tyre të brendshme ligjore të kërkuara për hyrjen në fuqi të kësaj marrëveshjeje.

Secila palë, në çdo kohë, mund të njoftojë palën tjetër, me shkrim, nëpërmjet kanaleve diplomatike, për synimin e saj për të përfunduar këtë marrëveshje. Kjo marrëveshje do të përfundojë gjashtë muaj pas marrjes së një njoftimi të tillë.

Përfundimi i kësaj marrëveshjeje nuk do të ndikojë në përmbushjen e projekteve tashmë të iniciuara, përveç rasteve kur bihet dakord ndryshe me shkrim nga të dyja palët.

Marrëveshja ndërmjet Këshillit të Ministrave të Republikës së Shqipërisë dhe qeverisë së Republikës së Azerbajxhanit, e nënshkruar më 8 prill 2013, do të shfuqizohet në datën e hyrjes në fuqi të kësaj marrëveshjeje. Të gjitha projektet dhe programet, kontratat dhe marrëveshjet tashmë të iniciuara, do të vazhdojnë të zhvillohen brenda kushteve të dakordësuara tashmë ose brenda kushteve të kësaj marrëveshjeje, përveç rasteve, kur bihet dakord ndryshe me shkrim nga të dyja palët.

Nënshkruar më 1.3.2024, në Baku, në dy kopje origjinale, secila në gjuhën shqipe, azere dhe angleze, të gjitha tekstet duke qenë njëloj autentike. Në rast të mospërputhjeve në interpretimin e marrëveshjes, teksti në anglisht do të ketë përparësi.

PËR KËSHILLIN E MINISTRAVE
TË REPUBLIKËS SË SHQIPËRISË
znj. Belinda Balluku

PËR QEVERINË E REPUBLIKËS
SË AZERBAJXHANIT
z. Mikayil Jabbarov

**AGREEMENT****ON ECONOMIC COOPERATION***between***THE COUNCIL OF MINISTERS OF THE REPUBLIC OF ALBANIA***and***THE GOVERNMENT OF THE REPUBLIC OF AZERBAIJAN**

The Council of Ministers of the Republic of Albania (hereinafter also referred as “GoA”) and the Government of the Republic of Azerbaijan, hereinafter collectively referred to as the “Parties” and individually referred to as either “Party”, “Albania” or “Azerbaijan”:

Confirming that the Parties have long standing friendly and productive relations and seek to strengthen bilateral cooperation in several economic sectors;

Noting that the Parties intend through this Agreement on Economic Cooperation to improve their economic cooperation;

Noting also that market-oriented reforms and a strong investment framework with appropriate incentives and robust investor protections on strategic projects are instrumental to attracting and sustaining foreign investment;

Also reiterating the importance of maintaining high standards related to health, safety, the environment, labor, transparency, and good governance for projects and acquisitions;

Have agreed on the followings :

Article 1

The Parties have a mutual interest in strengthening economic ties and promoting reciprocal commercial participation, and shall therefore encourage and promote cooperation between the two countries out of principles of friendship, full respect of sovereignty, territorial integrity and inviolability of international borders of both States, and common interests in accordance with relevant national legislations, international law, and provisions of this Agreement.

The Parties shall especially encourage economic and trade cooperation and strategic partnerships, in specific sectors and areas of interest, on the basis of equality and mutual benefits, pursuant to the terms and conditions set forth in this Agreement and under terms and conditions as defined in other documents concluded for the implementation of projects and programs foreseen in the priority projects and sectors, between the Parties and/or between one



The Parties acknowledge that the key priority projects and sectors targeted for cooperation within the framework of the agreement include, but are not limited to:

- a. trade and investments;
- b. energy and mining;
- c. transport and infrastructure;
- d. agriculture;
- e. tourism and environment;
- f. education and science;
- g. culture.

The Parties shall encourage cooperation between authorities, commercial and other public or private entities of both countries, as well as including citizens, in accordance with the national legislation of the Parties.

Article 2

The Parties shall pursue cooperation within the scope of this agreement, and pursuant to the national legislations, expertise and experience in the above-mentioned fields.

Also the Parties undertake to provide knowhow and build skill-based platforms on the improvement and professional development in the agreed priority projects and sectors, by sharing of best practices and concrete projects, including (but not limited to energy, critical technologies, and agriculture;

Article 3

Nothing in this Agreement shall prohibit the Parties to cooperate in other fields that are not covered with this Agreement.

Article 4

The Parties shall work on the implementation of this Agreement through the conclusion of Agreement/s, Memoranda of Understanding and relevant Protocols between governmental and private sector of both Parties and through intensification of official visits between respective officials or delegations.

Article 5

All investment and mutual cooperation arrangements that are included in the fields of cooperation pursuant article 1 and article 2 of this Agreement, shall be agreed and implemented under terms and conditions agreed by the Parties to this Agreement, or each Party and private sector, or private sector of both Parties, all regulated by separate relevant agreements/contracts and by specific procedures to be agreed by the parties accordingly.



Article 6

- 1) The Parties shall establish a Joint Intergovernmental Commission to work on the themes covered by this Agreement or any other themes to be agreed upon between the Parties.
- 2) The chairs of the commission(s) referred to in Article 6 (1) shall be defined through the official channels identified by the Parties after the agreement's entry in force.
- 3) The Commission shall recommend on the issues as follows:
 - a) A general review of this agreement with a view to furthering its objectives;
 - b) To discuss and review the implementation and operation of this agreement;
 - c) Identifying concrete areas or projects of cooperation between the parties;
 - d) Evaluation of the results obtained from the application of this agreement and consideration of any other issues or matters related to the interpretation and implementation of this agreement;
- 4) The Commission may, upon mutual consent of the Parties, invite representatives of relevant entities other than the representatives of the Parties with the necessary expertise relevant to the issues to be discussed, and hold joint meetings with the private sectors.
- 5) The Commission may establish commissions and sub-commissions and delegate specific tasks to such sub-commissions.
- 6) The Commission shall convene periodically to discuss and review the progress made on the issues above on a regular basis and to identify and explore further measures to enhance their cooperation and further progress the relations between the States.
- 7) The Competent Line Ministries of the two countries are empowered to act as concerned authorities entrusted with coordination, follow-up and the preparation for meetings of both Parties and their Sub-Commissions, and report on progress to the Parties.

Article 7

The cooperation under this Agreement shall not affect the rights and obligations of the Parties under other international treaties to which their States are party.

Article 8

Any dispute arising from the interpretation or application of this Agreement shall be settled amicably through consultations and negotiations between the two Parties via diplomatic channels.

Article 9

This Agreement may be amended by written mutual consent of the Parties. Such amendments shall be made in a form of separate protocols being an integral part of this Agreement and shall enter into force in accordance with Article 10 of this Agreement.

**Article 10**

This Agreement is concluded for an indefinite period and shall enter into force on the date of receipt by the both Parties of the last written notification through diplomatic channels confirming the completion of their respective internal procedures required for the entry into force of this Agreement.


Either Party may, at any time, notify the other Party in a written form through diplomatic channels of its intention to terminate this Agreement. This Agreement shall be terminated six months after the receipt of such notification.

Termination of this Agreement shall not affect fulfilment of projects already started, unless otherwise agreed upon in writing by both Parties.


The Agreement between the Government of the Republic of Azerbaijan and the Council of Ministers of the Republic of Albania, signed in Baku on 8 April 2013, shall cease to have effect on the date of entry into force of this Agreement. All projects and programs, contracts and agreements already initiated, shall continue to be developed within the terms already agreed or within the terms of this agreement unless otherwise agreed upon in writing by both Parties.

Signed in 1.03.2024 on Baku, in two original copies each in the Albanian, Azerbaijani and English languages, all texts being equally authentic. In the case of differences in the interpretation of the Agreement, the English text shall prevail.

**FOR THE COUNCIL OF
MINISTERS OF THE REPUBLIC
OF ALBANIA**


MS. BELINDA BALLUKU

**FOR THE GOVERNMENT OF THE
REPUBLIC OF AZERBAIJAN**


MR. MIKAYIL JABBAROV



DEKRET
Nr. 208, datë 31.5.2024

PËR SHPALLJE LIGJI

Në mbështetje të nenit 84, pika 1, dhe nenit 93 të Kushtetutës,

DEKRETOJ:

Shpalljen e ligjit nr. 51/2024, “Për ratifikimin e marrëveshjes për bashkëpunimin ekonomik ndërmjet Këshillit të Ministrave të Republikës së Shqipërisë dhe qeverisë së Republikës së Azerbajxhanit”.

**PRESIDENT I REPUBLIKËS
SË SHQIPËRISË**
Bajram Begaj

VENDIM
Nr. 50/2024

**PËR NGRITJEN E KOMISIONIT TË
POSAÇËM, PËR THELLIMIN E
REFORMAVE PËR MIRËQEVERISJEN,
SUNDIMIN E LIGJIT DHE
ANTIKORRUPSIONIN PËR
SHQIPËRINË 2030 NË BASHKIMIN
EVROPIAN**

Në mbështetje të neneve 7, 77, pika 1, 78 dhe 80, pika 3, të Kushtetutës; të neneve 24 e vijues të Rregullores së Kuvendit, si dhe në zbatim të rezolutës së Kuvendit të datës 27.5.2024, me propozim të një grupi deputetësh,

KUVENDI
I REPUBLIKËS SË SHQIPËRISË

VENDOSI:

I. Ngritjen e Komisionit të Posaçëm Parlamentar për Thellimin e Reformave për Mirëqeverisjen, Sundimin e Ligjit dhe Antikorrupsionin për Shqipërinë 2030 në Bashkimin Evropian.

II. Komisioni i Posaçëm, në zbatim të rezolutës së Kuvendit “Për thellimin e reformave për mirëqeverisjen, sundimin e ligjit dhe antikorrupsionin për Shqipërinë 2030 në Bashkimin Evropian”, ka

për qëllim kryesor të tij të drejtojë e të koordinojë një proces të thelluar reformimi, me synim:

1. Përmirësimin dhe konsolidimin e praktikave të mirëqeverisjes në të gjitha nivelet;
2. Thellimin e luftës kundër korrupsionit;
3. Forcimin e mëtejshëm të zbatimit të ligjit, duke pasur si udhërrëfyes gjetjet dhe rekomandimet e raporteve të Bashkimit Evropian dhe raportit *screening* të Komisionit Evropian për grupkapitullin e parë, si dhe adresimin e masave të udhërrëfyesve të miratuar nga qeveria “Për shtetin e së drejtës” dhe “Reformën në administratën publike”.

III. Komisioni i Posaçëm ka për objekt të veprimtarisë së tij që, përmes një procesi publik, gjithëpërfshirës e transparent, mbështetur në mekanizmat, rregullat dhe procedurat përkatëse parlamentare dhe me angazhimin e kontributin aktiv të ekspertizës më të mirë vendase dhe ndërkombëtare, të realizojë:

i. një vlerësim/analizë të situatës aktuale në të tria fushat, duke u mbështetur kryesisht në gjetjet dhe rekomandimet e shprehura në raportet e Bashkimit Evropian, përmes një angazhimi gjithëpërfshirës me institucionet e qeverisjes qendrore dhe vendore, agjencitë ekzekutive e ato publike të pavarura, institucionet e sistemit të drejtësisë, ekspertë vendas dhe ndërkombëtarë, subjekte të tjera të interesuara, organizatat e shoqërisë civile dhe vetë opinionin publik;

ii. hartimin dhe miratimin e një Plani Kombëtar Veprimi, me kohështrirje afatgjatë dhe të qëndrueshme për adresimin e sfidave përkatëse në këto fusha, duke rekomanduar edhe masa konkrete për ndryshime të mundshme ligjore dhe institucionale, të cilat duhet të adresohen në secilën fushë nga institucionet përgjegjëse.

IV. Komisioni i Posaçëm përbëhet nga 11 anëtarë, nga të cilët 6 janë përfaqësues të shumicës parlamentare dhe 5 përfaqësues të pakicës parlamentare.

Me qëllim ruajtjen konform rregullores të raportit shumicë-pakicë, shfrytëzimin efektiv të përvojës së krijuar qysh në fillesat e reformës në drejtësi, si dhe sigurimin e vazhdimësisë së punës e të produkteve të këtij procesi përtej legjislaturës aktuale dhe përgjatë harkut të negociatave me Bashkimin Evropian, komisioni si rregull do të përbëhet nga kryetarë dhe zëvendëskryetarë të komisioneve të përhershme për Çështjet Ligjore, Administratën Publike dhe të Drejtat e Njeriut (2);



për Ekonominë dhe Financat (2); për Çështjet Evropiane (2); për Edukimin dhe Mjetet e Informimit Publik (2); dhe Këshillit Kombëtar të Integritimit Evropian (2).

Emrat e anëtarëve të tij do të përcaktohen me vendim të Kuvendit.

V. Kryetari i komisionit është përfaqësues i shumicës parlamentare dhe zëvendëskryetari është përfaqësues i pakicës parlamentare.

VI. Komisioni i Posaçëm do të zhvillojë veprimtarinë e tij në një afat kohor 10-mujor. Në rast nevojë, me kërkesë të arsyetuar të komisionit, Kuvendi mund të vendosë zgjatjen e afatit të ushtrimit të veprimtarisë së komisionit.

VII. Komisioni i Posaçëm Parlamentar e organizon dhe e zhvillon veprimtarinë e tij mbështetur në dispozitat e Rregullores së Kuvendit për funksionimin e komisioneve parlamentare. Komisioni do të ndërmarrë të gjitha përpjekjet për të miratuar dokumentet përfundimtare nga një shumicë e konsiderueshme e deputetëve, duke e konsideruar kritike që ushtrimi të gëzojë mbështetje të gjerë dhe të pasqyrojë nevojën për ndërtimin e konsensusit që Kuvendi, populli shqiptar dhe partnerët ndërkombëtarë presin nga Komisioni i Posaçëm Parlamentar dhe procesi që ai do të zhvillojë dhe mbikëqyrë.

VIII. Pranë Komisionit të Posaçëm, për të realizuar një proces sa më gjithëpërfshirës e transparent, do të ngrihet dhe funksionojë grupi i punës i ekspertëve vendas dhe ndërkombëtarë me përfaqësues të propozuar nga institucionet e drejtësisë, institucionet e pavarura dhe agjencitë ekzekutive ligjzbatuese, administrata publike, bota akademike, universitetet publike dhe jopublike, institute e organizata të shoqërisë civile dhe medias, si edhe organizata të sipërmarrjes, etj.

Grupi i ekspertëve do të organizohet në 3 nëngrupe, që do të angazhohen për 3 fushat e objektit të veprimtarisë së këtij komisioni. Ekspertët do të angazhohen në funksion të temave përkatëse, që lidhen me fushat e tyre të veprimtarisë në procesin e kryerjes së analizës dhe hartimin e Planit Kombëtar të Veprimit, si dhe propozimin e masave përkatëse legjislative e institucionale.

Numri dhe përbërja e grupit të ekspertëve miratohet me vendim të komisionit.

Komisioni mund të ftojë për konsultime për çështje specifike edhe agjenci dhe ekspertë të tjerë

vendas e ndërkombëtarë të mirënjohur në fushat përkatëse.

IX. Komisioni i Posaçëm, për të garantuar një proces objektiv dhe në standardet më të mira ndërkombëtare, dhe plotësisht në përputhje me rekomandimet e Bashkimit Evropian, fton ekspertizën më të mirë ndërkombëtare, domosdoshmërisht të aleatëve tanë strategjikë, si Bashkimi Evropian dhe Shtetet e Bashkuara të Amerikës, duke krijuar mundësinë dhe pjesëmarrjen aktive të tyre përmes ekipeve të monitorimit dhe asistencës teknike.

Në cilësinë e ekspertëve ndërkombëtarë, komisioni mund të ftojë të marrin pjesë edhe përfaqësues të Këshillit të Evropës, Prezencës së OSBE-së, USAID-it, SIDA-s, vendeve anëtare të Bashkimit Evropian, Mbretërisë së Bashkuar, agjencive të ndryshme të specializuara në fushat përkatëse, si GRECO, OGP etj., si edhe lektorë me karriera të spikatura në vendet partnere të Shqipërisë për fushat e objektit të punës së tij.

X. Pranë Komisionit të Posaçëm ngrihet dhe funksionon një sekretariat teknik i përhershëm gjatë të gjithë mandatit të komisionit, i përbërë nga këshilltarë/specialistë të Shërbimit Juridik të Kuvendit, administratës publike, juristë të institucioneve të pavarura dhe agjencive ligjzbatuese, si edhe juristë të tjerë me përvojë që do të ftohen të kontribuojnë përkohësisht si pjesë e kësaj strukture gjatë mandatit të këtij komisioni. Sekretariati teknik do të shërbejë për të mbështetur Komisionin e Posaçëm dhe grupet e ekspertëve në kryerjen e detyrave të tyre.

XI. Komisioni i Posaçëm, për realizimin e objektit të tij të përcaktuar si më sipër, në bashkëpunim edhe me grupin e ekspertëve, do të organizojë:

- Seanca dëgjimore me qëllim konsultimi, tryeza pune dhe diskutime publike, lidhur me temat objekt pune të këtij komisioni me:

- i. institucionet e qeverisjes qendrore dhe vendore, sipas fushave përkatëse të përgjegjësisë;
- ii. institucionet e sistemit të drejtësisë;
- iii. institucionet publike të pavarura të krijuara nga Kuvendi;

iv. agjencitë ekzekutive ligjzbatuese, që kanë objekt të veprimtarisë së tyre luftën ndaj korrupsionit, administrimin e pasurisë publike, krimin ekonomik, parandalimin e pastrimit të parave, auditimin dhe inspektimin financiar,



kontrollin e brendshëm, informalitetin apo mbikëqyrjen e tregut, regjistrimin e administrimin e pronës etj.;

v. ekspertë të mirënjohur të fushave përkatëse;

vi. përfaqësues të organizatave të shoqërisë civile dhe grupeve të interesit;

vii. pedagogë e studentë;

viii. përfaqësues të organizatave të specializuara brenda e jashtë vendit, etj.;

- Mbledhjen dhe përpunimin e informacioneve dhe të dhënave të nevojshme nga struktura të ndryshme shtetërore në funksion të përmbushjes së objektit të tij;

- Përfshirjen në këtë proces të opinionit publik dhe veçanërisht të rinisë universitare, nëpërmjet hapësirave të bashkëbisedimit tematik dhe një portali *online* të krijuar posaçërisht për këtë qëllim, etj.

XII. Çdo parti tjetër joparlamentare, që nuk është e përfshirë në këtë komision, do të ftohet të marrë pjesë në aktivitetet e hapura, si dhe të ofrojë kontribute konkrete pranë komisionit dhe grupit të ekspertëve.

XIII. Këshilli i Ministrave mund të përfaqësohet në veprimtaritë e Komisionit me pjesëmarrjen e ministrit të Shtetit për Marrëdhëniet me Parlamentin, Kryenegociatorit, ministrit të Shtetit për Antikorrupsionin dhe Administratën Publike dhe ministrit të Shtetit për Pushtetin Vendor, të cilët do të mund të japin opinionet e tyre për çështje të caktuara, si edhe të kontribuojnë përmes ekspertëve të tyre.

XIV. Ngarkohet Byroja e Kuvendit dhe Sekretari i Përgjithshëm i Kuvendit për krijimin e kushteve të punës, mbështetjen financiare e logjistike të veprimtarisë së këtij Komisioni të Posaçëm, grupit të ekspertëve dhe sekretariatit teknik.

XV. Ky vendim hyn në fuqi menjëherë.

KRYETARE
Lindita Nikolla

Miraturar në datën 30.5.2024.

REZOLUTË

PËR VLERËSIMIN E VEPRIMTARISË SË INSTITUTIT TË STUDIMEVE PËR KRIMET DHE PASOJAT E KOMUNIZMIT NË SHQIPËRI PËR VITIN 2023

Kuvendi i Shqipërisë,

Duke vlerësuar rolin e Institutit të Studimeve për Krimet dhe Pasojat e Komunizmit në grumbullimin, administrimin, ruajtjen dhe dokumentimin e materialeve të kësaj periudhe në Shqipëri;

Duke njohur bashkëpunimin e këtij Instituti me institucionet kërkimore, kulturore, arsimore dhe institucione të tjera vendase e të huaja për shkëmbimin e informacionit e të përvojës lidhur me objektin e punës së Institutit;

Duke konsideruar se detyrat kryesore të punës së këtij Instituti kërkojnë mbështetjen e vazhdueshme të organeve shtetërore, medias, shoqërisë civile dhe partnerëve, në funksion të ruajtjes së kujtesës sonë kolektive,

Vlerëson veprimtarinë e Institutit të Studimeve për Krimet dhe Pasojat e Komunizmit për vitin 2023 në këto drejtime:

Intensifikimin e bashkëpunimit me shoqatat vendase dhe të diasporës për mbledhjen e dëshmive që janë jashtë kufijve, si një burim potencial për zgjerimin e arkivit audio-vizual apo kolanës së botimeve.

Angazhimin për zhvillimin e aktiviteteve në kuadër të edukimit qytetar, duke nxitur reflektimin dhe diskutim tek të rinjtë për krimet dhe pasojat e komunizmit në vendin tonë përmes përdorimit të formave inovative të informimit.

Evidentimin e viktimave të regjimit komunist me botimin e vëllimit 12 të Fjalorit Enciklopedik të Viktimave të Terrorit Komunist në Shqipëri.

Realizimin e konferencës shkencore me fokus gjendjen e shqiptarëve gjatë periudhës së komunizmit (1944–1990).

Përkujtimin e ngjarjeve të rëndësishme të qëndresës antikomuniste gjatë regjimit komunist, siç ishte revolta e të burgosurve politikë në kamp-burgun e Spaçit, përmes realizimit të filmit dokumentar, simpoziumit dhe ekspozitës me dokumente për këtë ngjarje.



Rritjen e aksesit publik përmes promovimit të gjerë të veprave të ISKK-së dhe shpërndarjes së tyre falas në disa biblioteka të vendit.

Kuvendi kërkon që Instituti i Studimeve për Krimet dhe Pasojat e Komunizmit për vitin 2024, në përmbushje të detyrave të ngarkuara me ligj, të angazhohet veçanërisht edhe në këto drejtime:

1. Të prezantojë studimet e kryera para audiencave të ekspertëve, akademikëve dhe aktorëve të ndryshëm të të drejtave të njeriut për të shkëmbyer gjetjet e hulumtimit mbi periudhën komuniste dhe për nxitjen e debatit shkencor e atij publik mbi këto hulumtime.

2. Të konkretizojë bashkëpunimin me Autoritetin për Informimin mbi Dokumente të ish-Sigurimit të Shtetit për pasurimin e databazës me të dhëna statistikore të viktimave të komunizmit në Shqipëri në të tria kategoritë: ekzekutim, burgim dhe internim, si dhe t'i bëjë sa më parë të aksesueshme për qytetarët.

3. Në kuadër të bashkëpunimit me Ministrinë e Arsimit dhe Sportit, të ofrojë një lidhje të drejtpërdrejtë me historinë e komunizmit nëpërmjet leksioneve ndërvepruese në shkolla, si dhe vizitave të të rinjve në vendet e kujtesës (ish-burgje politike, kampe pune, kampe internimi, muze, etj.).

4. Në kuadër të transparencës, të publikohen në faqen zyrtare të institucionit vendimet e Këshillit Shkencor, si dhe procesverbalet e mbledhjeve të Këshillit Shkencor dhe Bordit Drejtues.

5. Të organizojë konferenca dhe debate publike për trashëgiminë materiale të komunizmit dhe për aspekte të caktuara të saj, si: estetika e ambientit në përgjithësi, arkitektura, planifikimi urban dhe veprat monumentale.

6. Në bashkëpunim me historianë dhe ekspertë të shkencave didaktike të hartojë dhe botojë një udhëzues praktik për mësuesit me orientime didaktike për qasjen ndaj historisë së komunizmit.

7. Të inkurajojë një qasjeje analitike dhe të pavarur ndaj komunizmit tek të rinjtë përmes përfshirjes aktive në projekte krijuese, ekspozita dhe konkurse shkollore.

8. Të angazhohet në projekte, bashkëpunime me institucionet homologe jashtë vendit, me qëllim përthithjen e eksperiencave më të mira në funksion të veprimtarisë së institucionit.

9. Të bashkëpunojë me Ministrinë e Ekonomisë, Kulturës dhe Inovacionit për të pasuruar kole-

sionin e muzeve të ndryshëm në vend me botimet e Institutit të Studimeve për Krimet dhe Pasojat e Komunizmit

KRYETARE
Lindita Nikolla

Miraturar në datën 30.5.2024.

DEKRET
Nr. 212, datë 3.6.2024

PËR LEJIMIN E LËNIES SË
SHTETËSISË SHQIPTARE

Në mbështetje të nenit 92, shkronjës “c”, nenit 93 të Kushtetutës; të neneve 13, 20 e në vijim të ligjit nr. 113/2020, “Për shtetësinë”, me propozim të Ministrisë së Brendshme,

DEKRETOJ:

Neni 1

I lejohet lënia e shtetësisë shqiptare, me kërkesë të tij, shtetasit:

1. Drini Dashnor Çorbaxhi

Neni 2

Ky dekret hyn në fuqi menjëherë dhe botohet në Fletoren Zyrtare.

PRESIDENT I REPUBLIKËS
SË SHQIPËRISË
Bajram Begaj

DEKRET
Nr. 213, datë 3.6.2024

PËR DHËNIE TË SHTETËSISË
SHQIPTARE

Në mbështetje të nenit 92, shkronjës “c”, nenit 93 të Kushtetutës; të neneve 8, 20 e në vijim të ligjit nr. 113/2020, “Për shtetësinë”, me propozim të ministrit të Brendshëm,



DEKRETOJ:

Neni 1

Dhënien e shtetësisë shqiptare, me kërkesë të tyre, shtetasve:

1. Stefano Oreste Marcelli
2. Fatlume Sami Gjonaj (Gashi)
3. Ibrahim Ahmet (Ahmad) Mahli

Neni 2

Ky dekret hyn në fuqi menjëherë dhe botohet në Fletoren Zyrtare.

PRESIDENT I REPUBLIKËS
SË SHQIPËRISË
Bajram Begaj

DEKRET
Nr. 214, datë 3.6.2024

**PËR DHËNIE TË SHTETËSISË
SHQIPTARE**

Në mbështetje të nenit 92, shkronjës “c”, nenit 93 të Kushtetutës; të neneve 8, 20 e në vijim të ligjit nr. 113/2020, “Për shtetësinë”, me propozim të ministrit të Brendshëm,

DEKRETOJ:

Neni 1

Dhënien e shtetësisë shqiptare, me kërkesë të tyre, shtetasve:

1. Mahmut Ali Dalaslan
2. Natalia Jurevna Jurij Nikolljevic Danilova
3. Saleh Mohammed Abdullah Mohammed Abdullah Al-Awdi

Neni 2

Ky dekret hyn në fuqi menjëherë dhe botohet në Fletoren Zyrtare.

PRESIDENT I REPUBLIKËS
SË SHQIPËRISË
Bajram Begaj

DEKRET

Nr. 215, datë 3.6.2024

**PËR DHËNIE TË SHTETËSISË
SHQIPTARE**

Në mbështetje të nenit 92, shkronjës “c”, nenit 93 të Kushtetutës; të neneve 8, 20 e në vijim të ligjit nr. 113/2020, “Për shtetësinë”, me propozim të ministrit të Brendshëm,

DEKRETOJ:

Neni 1

Dhënien e shtetësisë shqiptare, me kërkesë të tyre, shtetasve:

1. Jeton Rizah Trolli
2. Nderim Florim Shefkiu
3. Kaddour Ahmed Ould Arous
4. Hurşithan İhsan Karaman

Neni 2

Ky dekret hyn në fuqi menjëherë dhe botohet në Fletoren Zyrtare.

PRESIDENT I REPUBLIKËS
SË SHQIPËRISË
Bajram Begaj

DEKRET

Nr. 216, datë 3.6.2024

**PËR DHËNIE TË SHTETËSISË
SHQIPTARE**

Në mbështetje të nenit 92, shkronjës “c”, nenit 93 të Kushtetutës; të neneve 8, 20 e në vijim të ligjit nr. 113/2020, “Për shtetësinë”, me propozim të ministrit të Brendshëm,

DEKRETOJ:

Neni 1

Dhënien e shtetësisë shqiptare, me kërkesë të tij, shtetasit:

1. Arber Memet Memeti



Neni 2

Ky dekret hyn në fuqi menjëherë dhe botohet në Fletoren Zyrtare.

PRESIDENT I REPUBLIKËS
SË SHQIPËRISË
Bajram Begaj

DEKRET**Nr. 217, datë 3.6.2024****PËR DHËNIE TË SHTETËSISË
SHQIPTARE**

Në mbështetje të nenit 92, shkronjës “c”, nenit 93 të Kushtetutës; të neneve 8, 20 e në vijim të ligjit nr. 113/2020, “Për shtetësinë”, me propozim të ministrit të Brendshëm,

DEKRETOJ:

Neni 1

Dhënien e shtetësisë shqiptare, me kërkesë të saj, shtetas:

1. Hala Ali Matawea

Neni 2

Ky dekret hyn në fuqi menjëherë dhe botohet në Fletoren Zyrtare.

PRESIDENT I REPUBLIKËS
SË SHQIPËRISË
Bajram Begaj

DEKRET**Nr. 218, datë 3.6.2024****PËR DHËNIE TË SHTETËSISË
SHQIPTARE**

Në mbështetje të nenit 92, shkronjës “c”, nenit 93 të Kushtetutës; të neneve 8, 20 e në vijim të ligjit nr. 113/2020, “Për shtetësinë”, me propozim të ministrit të Brendshëm,

DEKRETOJ:

Neni 1

Dhënien e shtetësisë shqiptare, me kërkesë të tij, shtetasit:

1. Engideniz Fatih Tunçer

Neni 2

Ky dekret hyn në fuqi menjëherë dhe botohet në Fletoren Zyrtare.

PRESIDENT I REPUBLIKËS
SË SHQIPËRISË
Bajram Begaj

DEKRET**Nr. 219, datë 3.6.2024****PËR DHËNIE TË SHTETËSISË
SHQIPTARE**

Në mbështetje të nenit 92, shkronjës “c”, nenit 93 të Kushtetutës; të neneve 16, 20 e në vijim të ligjit nr. 113/2020, “Për shtetësinë”, me propozim të ministrit të Brendshëm,

DEKRETOJ:

Neni 1

Dhënien e shtetësisë shqiptare, me kërkesë të tij, shtetasit:

1. Ilir Enver Dibra

Neni 2

Ky dekret hyn në fuqi menjëherë dhe botohet në Fletoren Zyrtare.

PRESIDENT I REPUBLIKËS
SË SHQIPËRISË
Bajram Begaj

**DEKRET****Nr. 220, datë 3.6.2024****PËR DHËNIE TË SHTETËSISË
SHQIPTARE**

Në mbështetje të nenit 92, shkronjës “c”, nenit 93 të Kushtetutës; të neneve 8, 20 e në vijim të ligjit nr. 113/2020, “Për shtetësinë”, me propozim të ministrit të Brendshëm,

DEKRETOJ:**Neni 1**

Dhënien e shtetësisë shqiptare, me kërkesë të tyre, shtetasve:

1. Osman Zeqir Osmani
2. Sami Nuhi Berisha

Neni 2

Ky dekret hyn në fuqi menjëherë dhe botohet në Fletoren Zyrtare.

**PRESIDENT I REPUBLIKËS
SË SHQIPËRISË
Bajram Begaj**

DEKRET**Nr. 221, datë 3.6.2024****PËR DHËNIE TË SHTETËSISË
SHQIPTARE**

Në mbështetje të nenit 92, shkronjës “c”, nenit 93 të Kushtetutës; të neneve 8, 20 e në vijim të ligjit nr. 113/2020, “Për shtetësinë”, me propozim të ministrit të Brendshëm,

DEKRETOJ:**Neni 1**

Dhënien e shtetësisë shqiptare, me kërkesë të tyre, shtetasve:

1. Vjollca Ramadan Latifi
2. Murat Mikdat Yildirim
3. Arben Milaim Seferi
4. Bashkim Hamdi Muqaj

Neni 2

Ky dekret hyn në fuqi menjëherë dhe botohet në Fletoren Zyrtare.

**PRESIDENT I REPUBLIKËS
SË SHQIPËRISË
Bajram Begaj**

DEKRET**Nr. 222, datë 4.6.2024****PËR DHËNIE TË SHTETËSISË
SHQIPTARE**

Në mbështetje të nenit 92, shkronjës “c”, nenit 93 të Kushtetutës; të neneve 8, 20 e në vijim të ligjit nr. 113/2020, “Për shtetësinë”, me propozim të ministrit të Brendshëm,

DEKRETOJ:**Neni 1**

Dhënien e shtetësisë shqiptare, me kërkesë të tyre, shtetasve:

1. Vlora Ismet Marmullakaj (Istogu)
2. Shqipe Bashkim Ziba (Devetaku)

Neni 2

Ky dekret hyn në fuqi menjëherë dhe botohet në Fletoren Zyrtare.

**PRESIDENT I REPUBLIKËS
SË SHQIPËRISË
Bajram Begaj**

DEKRET**Nr. 223, datë 4.6.2024****PËR DHËNIE TË SHTETËSISË
SHQIPTARE**

Në mbështetje të nenit 92, shkronjës “c”, nenit 93 të Kushtetutës; të neneve 16, 20 e në vijim të ligjit nr. 113/2020, “Për shtetësinë”, me propozim të ministrit të Brendshëm,



DEKRETOJ:

Neni 1

Dhënien e shtetësisë shqiptare, me kërkesë të saj, shtetas:

1. Bena Ylli Mero

Neni 2

Ky dekret hyn në fuqi menjëherë dhe botohet në Fletoren Zyrtare.

PRESIDENT I REPUBLIKËS
SË SHQIPËRISË
Bajram Begaj

DEKRET
Nr. 224, datë 5.6.2024

**PËR DHËNIE TË SHETËSISË
SHQIPTARE**

Në mbështetje të nenit 92, shkronja “c”, nenit 93 të Kushtetutës; të neneve 6, 20 e në vijim të ligjit nr. 113/2020, “Për shtetësinë”, me propozim të ministrit të Brendshëm

DEKRETOJ:

Neni 1

Dhënien e shtetësisë shqiptare, me kërkesë të tij, shtetasit:

1. Oweis Khaled Darra

Neni 2

Ky dekret hyn në fuqi menjëherë dhe botohet në Fletoren Zyrtare.

PRESIDENT I REPUBLIKËS
SË SHQIPËRISË
Bajram Begaj

VENDIM

Nr. 331, datë 5.6.2024

PËR LIRIM NGA DETYRA

Në mbështetje të nenit 100 të Kushtetutës dhe të pikës 2, të nenit 6, të ligjit nr. 9000, datë 30.1.2003, “Për organizimin dhe funksionimin e Këshillit të Ministrave”, me propozimin e Kryeministrit, Këshilli i Ministrave

VENDOSI:

Znj. Vjollca Braho, zëvendësministër i Shëndetësisë dhe Mbrojtjes Sociale, lirohet nga kjo detyrë.
Ky vendim hyn në fuqi menjëherë.

ZËVENDËSKRYEMINISTËR
Belinda Balluku

VENDIM
Nr. 332, datë 5.6.2024

PËR EMËRIM NË DETYRË

Në mbështetje të nenit 100 të Kushtetutës dhe të pikës 2, të nenit 6, të ligjit nr. 9000, datë 30.1.2003, “Për organizimin dhe funksionimin e Këshillit të Ministrave”, me propozimin e Kryeministrit, Këshilli i Ministrave

VENDOSI:

Z. Niko Hyka emërohet zëvendësministër i Shëndetësisë dhe Mbrojtjes Sociale.
Ky vendim hyn në fuqi menjëherë.

ZËVENDËSKRYEMINISTËR
Belinda Balluku

VENDIM
Nr. 333, datë 5.6.2024

PËR EMËRIM NË DETYRË

Në mbështetje të nenit 100 të Kushtetutës dhe të pikës 2, të nenit 6, të ligjit nr. 9000, datë 30.1.2003, “Për organizimin dhe funksionimin e Këshillit të Ministrave”, me propozimin e Kryeministrit, Këshilli i Ministrave



VENDOSI:

Z. Dorian Tola emërohet zëvendësministër i Mbrojtjes.

Ky vendim hyn në fuqi menjëherë.

ZËVENDËSKRYEMINISTËR
Belinda Balluku

VENDIM
Nr. 334, datë 5.6.2024

**PËR LIRIMIN NGA DETYRA TË
DREJTORIT TË PËRGJITHSHËM
TË TATIMEVE**

Në mbështetje të nenit 100 të Kushtetutës dhe të pikës 2, të nenit 17, të ligjit nr. 9920, datë 19.5.2008, “Për procedurat tatimore në Republikën e Shqipërisë”, të ndryshuar, me propozimin e ministrit të Financave, Këshilli i Ministrave

VENDOSI:

Z. Ceno Klosi, drejtor i përgjithshëm i Tatimeve, lirohet nga kjo detyrë.

Ky vendim hyn në fuqi menjëherë dhe botohet në Fletoren Zyrtare.

ZËVENDËSKRYEMINISTËR
Belinda Balluku

VENDIM
Nr. 335, datë 5.6.2024

PËR EMËRIM NË DETYRË

Në mbështetje të nenit 100 të Kushtetutës dhe të pikës 2, të nenit 6, të ligjit nr. 9000, datë 30.1.2003, “Për organizimin dhe funksionimin e Këshillit të Ministrave”, me propozimin e Kryeministrit, Këshilli i Ministrave

VENDOSI:

Z. Ceno Klosi emërohet zëvendësministër i Infrastrukturës dhe Energjisë.

Ky vendim hyn në fuqi menjëherë.

ZËVENDËSKRYEMINISTËR
Belinda Balluku

VENDIM

Nr. 37, datë 7.5.2024

**NË EMËR TË REPUBLIKËS
SË SHQIPËRISË**

Gjykata Kushtetuese e Republikës së Shqipërisë,
e përbërë nga:

Holta Zaçaj	kryetare;
Marsida Xhaferllari	anëtare;
Fiona Papajorgji	anëtare;
Elsa Toska	anëtare;
Sandër Beci	anëtar;
Ilir Toska	anëtar;
Genti Ibrahim	anëtar;
Marjana Semini	anëtare;
Sonila Bejtja	anëtare;

me sekretare Belma Lleshi, më datë 7.5.2024 mori në shqyrtim në seancë plenare mbi bazë të dokumenteve çështjen nr. 13 (B) 2023 të Regjistrimit Themeltar, që u përket:

KËRKUESE: Bardhoke Picaku, përfaqësuar nga avokat Marash Logu, me prokurë të posaçme.

SUBJEKT I INTERESUAR: Shërbimi Social Shtetëror, KMCAP Epror Paraplegji, Tetraplegji dhe Neurologji përfaqësuar nga drejtori i përgjithshëm Reme Xholi.

OBJEKTI: Shfuqizimi i vendimit nr. 00-2023-2304, datë 6.6.2023 të Kolegjit Administrativ të Gjykatës së Lartë, si i papajtueshëm me Kushtetutën e Republikës së Shqipërisë.

Konstatimi i shkeljes së afatit të arsyeshëm të gjykimit të çështjes administrative nr. 31155-00075-86-2022, me datë regjistrimi 19.1.2022 në Gjykatën Administrative të Apelit.

Detyrimi i Gjykatës Administrative të Apelit që të gjykojë çështjen brenda një afati kohor të caktuar, sa më të afërt.

BAZA LIGJORE: Nenet 42, 131, pika 1, shkronja “P” dhe 134, pika 1, shkronja “I”, të Kushtetutës së Republikës së Shqipërisë (*Kushtetuta*); neni 6 i Konventës Evropiane për të Drejtat e Njeriut; nenet 71 e vijues të ligjit nr. 8577, datë 10.2.2000 “Për organizimin dhe funksionimin e Gjykatës Kushtetuese të Republikës së Shqipërisë”, të ndryshuar (*ligji nr. 8577/2000*).



GJYKATA KUSHTETUESE,

pasi dëgjoi relatoren e çështjes Sonila Bejtja, mori në shqyrtim pretendimet e kërkuases Bardhoke Picaku, e cila ka kërkuar pranimin e kërkesës, prapësimet e subjektit të interesuar, Shërbimit Social Shtetëror, KMCAP Epror Paraplegji, Tetraplegji dhe Neurologji, (KMCAP Epror) që ka kërkuar rrëzimin e kërkesës, si dhe diskutoi çështjen në tërësi,

VËREN:

I

Rrethanat e çështjes

1. Kërkuësja rezulton se është nëna e shtetases B.P., e cila që nga moshë trevjeçare është diagnostikuar me diagnozën “paraplegji”. Gjithashtu, rezulton se me vendimin nr. 173, datë 27.4.2010 të Komisionit Mjekësor të Caktimit të Aftësisë për Punë (KMCAP) Mirditë, vajza e kërkuases është trajtuar me statusin e paraplegjikut, duke përfutur edhe paketën e veçantë higjienosanitare.

2. Në rikomisionimin e radhës të kryer nga KMCAP-ja Niveli i Parë për Paraplegji Tetraplegji dhe Neurologji Tiranë vajza e kërkuases është kontrolluar për diagnozën “paraplegji inferiore”, në vijim të epikrizës së lëshuar nga mjeku specialist neuropsikiatër i Poliklinikës së Specialiteteve Mirditë. Me vendimin nr. 877, datë 27.10.2020, KMCAP-ja Niveli i Parë për Paraplegji Tetraplegji dhe Neurologji Tiranë, ka vendosur dhënien e së drejtës së përfutimit të statusit të paraplegjikut nga data 1.6.2021 deri më datë 1.6.2023, më të drejtë rikomisionimi. Duke qenë se ky vendim është marrë me shumicë votash, pasi kryetari i komisionit nuk ka qenë dakord, vajza e kërkuases ka kaluar për shqyrtim pranë KMCAP-së Epror, me argumentin se është vlerësuar me statusin e paraplegjikut në moshën trevjeçare. Më pas nuk ka pasur asnjë ekzaminim të kryer ose kontroll në Qendrën Spitalore Universitare Tiranë për statusin e paraplegjikut.

3. KMCAP-ja Epror, me vendimin nr. 414, datë 24.6.2021, ka vendosur që diagnoza e konstatuar është “*Paraparezë inferiore spastike sinistër me shumë se dexter probabilisht në terren PCSI, epilepsia e gjeneralizuar*”. Pas kryerjes së vizitës dhe vlerësimit të dokumentacionit mjekësor dhe ekzaminimeve

përkatese, KMCAP-ja Epror ka arritur në përfundimin se vajza e kërkuases nuk përfiton statusin e paraplegjikut, por kalon si përfituese e pagesës së aftësisë së kufizuar, grupi i parë me kujdestar. Në këto kushte, kërkuësja i është drejtuar gjykatës me kërkesëpadi me objekt shfuqizimin e vendimit nr. 414, datë 24.6.2021 të KMCAP-së Epror.

4. Gjykata Administrative e Shkallës së Parë Tiranë, me vendimin nr. 3194, datë 16.11.2021, ka vendosur rrëzimin e kërkesëpadisë. Kundër këtij vendimi ka bërë ankim kërkuësja, i cili është regjistruar në sekretarinë e Gjykatës Administrative të Apelit më datë 19.1.2022. Më datë 15.2.2023, kërkuësja i është drejtuar Gjykatës Administrative të Apelit me kërkesë për përshpejtimin e çështjes.

5. Sipas informacionit të datës 26.4.2024 të Gjykatës Administrative të Apelit, çështja i ka kaluar me short fillimisht gjyqtarës B.H., më pas gjyqtarës A.N. më datë 15.3.2023 dhe gjyqtarës E.V. më datë 19.9.2023 dhe aktualisht është për shqyrtim nga gjyqtari relator S.I., të cilit i ka kaluar më datë 11.1.2024. Gjykata Administrative e Apelit ka 11 gjyqtarë dhe gjyqtari relator ka 2293 çështje në shqyrtim. Aktualisht, kjo gjykatë po shqyrton çështjet e regjistruara në vitin 2017, si dhe çështjet me përshpejtim me kërkesë të palëve, sipas vendimit nr. 78, datë 30.5.2019 të Këshillit të Lartë Gjyqësor “Për kalendarin e shqyrtimit të çështjeve në gjykatën e apelit”.

6. Në kushtet kur çështja nuk është marrë në shqyrtim, më datë 24.4.2023 kërkuësja ka depozituar në Gjykatën e Lartë kërkesën me objekt konstatimin e shkeljes së afatit të arsyeshëm të gjykimit të çështjes së saj në Gjykatën Administrative të Apelit dhe marrjen e masave për gjykimin sa më të shpejtë të saj.

7. Kolegji Administrativ i Gjykatës së Lartë, me vendimin nr. 00-2023-2304, datë 6.6.2023, ka vendosur rrëzimin e kërkesës. Më datë 27.10.2023 kërkuësja i është drejtuar Gjykatës Kushtetuese (Gjykata) me ankim kushtetues individual për shfuqizimin e këtij vendimi dhe konstatimin e shkeljes së afatit të arsyeshëm të gjykimit të çështjes në Gjykatën Administrative të Apelit. Ky ankim kushtetues individual është dorëzuar në Gjykatë më datë 27.10.2023 dhe pasi është plotësuar sipas kërkesave të nenit 27 të ligjit nr. 8577/2000, është regjistruar më datë 3.11.2023. Kolegji i Gjykatës më datë 28.12.2023 ka vendosur kalimin e çështjes për



shqyrtim në seancë plenare mbi bazë të dokumenteve.

II

Pretendimet në Gjykatën Kushtetuese

8. **Kërkuesja**, në mënyrë të përmbledhur, ka parashtruar se i është cenuar e drejta për proces të rregullt ligjor në drejtim të kohëzgjatjes së paarsyeshme të procesit gjyqësor, për sa vijon:

8.1 Ankimi është regjistruar në Gjykatën Administrative të Apelit më datë 19.1.2022, por ende nuk ka një vendim për çështjen. Nga ana e Gjykatës Administrative të Apelit nuk janë respektuar afatet ligjore, duke i zvarritur ato në mënyrë të paarsyeshme. Gjithashtu, vlerësimi i bërë nga Kolegji Administrativ i Gjykatës së Lartë nuk është në përputhje me Kushtetutën, për rrjedhojë vendimi i tij duhet të shfuqizohet dhe ankimi i kërkueses i bërë në Gjykatën Administrative të Apelit duhet të përshpejtohet.

8.2 *Sjellja e kërkueses*. Kërkuesja ka vepruar në përputhje me të drejtat procedurale dhe nuk rezulton të jetë bërë shkak ose të ketë shkaktuar vonesa në këtë drejtim, përkundrazi, nuk e ka humbur interesin, madje e ka shfaqur atë në mënyrë të pandërprerë, duke kërkuar përshpejtimin e çështjes.

8.3 *Kompleksiteti i çështjes*. Çështja konkrete nuk është komplekse, pasi përpara gjykatës është paraqitur vetëm një pretendim dhe gjykatës së shkallës së parë iu deshën vetëm dy muaj për gjykimin e saj. Kjo është pranuar edhe nga Kolegji Administrativ i Gjykatës së Lartë.

8.4 *Sjellja e autoriteteve*. Gjykata Administrative e Apelit dhe Kolegji Administrativ i Gjykatës së Lartë kanë vepruar në kundërshtim me ligjin material dhe me praktikën që vetë ai kolegji ka vendosur për raste të ngjashme, kur objekt padie është vendimi i KMCAP-së Epror. Çështjet që kanë të bëjnë me të drejtat e fëmijës ose që kanë ndikim te një fëmijë i mitur u jepet përparësi dhe duhen përshpejtuar nga gjykatat. Fakti që gjykatat në Shqipëri janë duke përballuar një volum të madh çështjes, si pasojë e pakësimit të gjyqtarëve nëpër gjykata për shkak të vetingut nuk e justifikon vonesën në shqyrtimin e çështjes.

8.5 *Rëndësia e asaj çfarë rrezikon kërkuesja*. Interesi i kërkueses rrezikohet nga tejzgjatja e tepruar e procedurave gjyqësore, për sa kohë që e drejta e

kërkuar ka të bëjë me të drejta vetjake, siç është përfitimi i pensionit, sidomos kur bëhet fjalë për të drejta të cilat ndikojnë te një person i mitur me aftësi të kufizuara.

9. **Subjekti i interesuar, KMCAP Epror**, në mënyrë të përmbledhur, ka prapësuar si vijon:

9.1 Aktualisht kërkuesja trajtohet me pagesë të aftësisë së kufizuar, grupi i parë, në të cilin vlerësohen personat me aftësi të kufizuara që kanë nevojë për përkujdesje, pra nuk i janë cenuar mjetet e domosdoshme të jetesës, përkatësisht e drejta e pensionit, siç është pretenduar nga kërkuesja. Masa e pensionit për personat me aftësi të kufizuara aktualisht është 12.415 lekë në muaj dhe të njëjtën shumë e përfiton edhe ndihmësi personal, pagesa të cilat indeksohen çdo vit nga Shërbimi Social Shtetëror. Subjekti i interesuar ka vepruar në përputhje me të drejtat dhe detyrimet procedurale dhe nuk rezulton të jetë bërë pengesë për vonesa në gjykimin e çështjes.

III

Vlerësimi i Gjykatës Kushtetuese

A. Për legjitimitimin e kërkueses

10. Çështja e legjitimitimit (*locus standi*) është një ndër aspektet kryesore që lidhet me nisjen e një procesi kushtetues. Sipas neneve 131, pika 1, shkronja “P” dhe 134, pikat 1, shkronja “I” dhe 2, të Kushtetutës, si dhe nenit 71 të ligjit nr. 8577/2000, çdo individ, person fizik ose juridik, subjekt i së drejtës private dhe publike, mund të vërë në lëvizje Gjykatën për gjykimin përfundimtar të ankesave kundër çdo akti të pushtetit publik ose vendimi gjyqësor që cenon të drejtat dhe liritë themelore të garantuara në Kushtetutë. Ankimi kushtetues individual, në çdo rast, duhet të plotësojë kriteret kumulative të nenit 71/a të ligjit nr. 8577/2000, që lidhen me shterimin e mjeteve juridike, afatin e paraqitjes së kërkesës, pasojat negative të pësura në mënyrë të drejtpërdrejtë e reale dhe mundësinë për rivendosjen e së drejtës së shkelur.

11. Në këtë këndvështrim, kërkuesja, si individ, legjitimohet *ratione personae*, në kuptim të shkronjës “P” të pikës 1 të nenit 131 dhe shkronjës “I” të pikës 1 të nenit 134 të Kushtetutës, pasi është palë në çështjen objekt të ankimit kushtetues individual, për rrjedhojë ka interes të drejtpërdrejtë për vënien në lëvizje të këtij gjykimi kushtetues.



12. Një kriter tjetër është edhe ai për *shterimin e mjeteve juridike efektive*, i parashikuar nga nenet 131, pika 1, shkronja “P” dhe 134, pika 1, shkronja “I”, të Kushtetutës, si dhe neni 71/a, pika 1, shkronja “a”, i ligjit nr. 8577/2000, që kërkon shfrytëzimin në rrugë normale të mjeteve juridike efektive, të cilat janë të përshtatshme, të disponueshme dhe të frytshme për një çështje konkrete. Gjykata pas ndryshimeve që iu bënë Kodit të Procedurës Civile (KPC) me ligjin nr. 38/2017, ka mbajtur qëndrimin se nuk mund të investohej drejtpërdrejt për shqyrtimin e kërkesave për konstatimin e cenimit të së drejtës për gjykim brenda afatit të arsyeshëm, duke arsyetuar se legjislacioni i brendshëm parashikon tashmë mjete juridike që i ofrojnë individit rezultate konkrete për rivendosjen e kësaj të drejte kushtetuese. Në këtë kuptim, individit duhet t’u drejtohet gjykatave të zakonshme, në përputhje me parashikimet e KPC-së, dhe vetëm pasi të ketë shteruar garancitë e mbrojtjes që i ofrohen nga juridiksioni i zakonshëm gjyqësor, ai mund të vërë në lëvizje gjykimin kushtetues (*shih vendimet nr. 46, datë 3.10.2023; nr. 44, datë 26.9.2023; nr. 2, datë 17.2.2022 të Gjykatës Kushtetuese*).

13. Në rastin konkret, Gjykata vëren se kërkesja i është drejtuar Gjykatës me ankim kushtetues individual, pasi ka paraqitur më parë kërkesë në Gjykatën e Lartë, në zbatim të nenit 399/6 të KPC-së, për konstatimin e shkeljes së afatit të arsyeshëm dhe përshpejtimin e shqyrtimit të çështjes së saj të regjistruar në Gjykatën Administrative të Apelit, për të cilën Kolegji Administrativ i Gjykatës së Lartë ka vendosur rrëzimin e saj. Për rrjedhojë, i vetmi mjet në dispozicion të kërkuësës për rivendosjen e së drejtës së pretenduar të cenuar është ankimi kushtetues individual.

14. Gjykata vlerëson se kërkesja legjitimohet edhe *ratione temporis*, pasi jo vetëm që shkelja është vazhduese, por edhe vendimi i Kolegjit Administrativ të Gjykatës së Lartë që ka shqyrtuar kërkesën për konstatimin e cenimit dhe përshpejtimin e procedurave mban datën 6.6.2023, me të cilin kërkesja është njohur përmes shërbimit postar më datë 26.9.2023, kurse ankimi kushtetues individual është paraqitur në Gjykatë më datë 27.10.2023, pra brenda afatit ligjor 4-mujor të parashikuar nga neni 71/a, pika 1, shkronja “b”, i ligjit nr. 8577/2000.

15. Për sa i takon legjitimitetin *ratione materiae*, në thelb, objekt i ankimit kushtetues individual është

kohëzgjatja e shqyrtimit të çështjes së kërkuësës të regjistruar në Gjykatën Administrative të Apelit, për të cilën ende nuk ka një vendimmarrje dhe as një datë të planifikuar për shqyrtimin e saj. Për rrjedhojë, pretendimet e kërkuësës do të vlerësohen në këndvështrim të së drejtës për t’u gjykuar brenda një afati të arsyeshëm, e cila, në kuptim të neneve 42 dhe 131, pika 1, shkronja “P”, të Kushtetutës, bën pjesë në juridiksionin kushtetues.

B. Për themelin e pretendimeve

B.1 Për shqyrtimin e çështjes brenda një afati të arsyeshëm

16. Sipas kërkuësës, ankimi i saj është regjistruar në Gjykatën Administrative të Apelit më datë 19.1.2022 dhe ende nuk ka një vendim për çështjen. Nga ana e Gjykatës Administrative të Apelit nuk janë respektuar afatet ligjore, duke i zvarritur ato në mënyrë të paarsyeshme.

17. Neni 42 i Kushtetutës parashikon, ndër të tjera, se kushdo, për mbrojtjen e të drejtave, lirive dhe interesave të tij kushtetues dhe ligjorë ose në rastin e akuzave të ngritura kundër tij, ka të drejtën e një gjykimi të drejtë dhe publik brenda një afati të arsyeshëm. Në jurisprudencën e saj Gjykata ka vlerësuar se kohëzgjatja e gjykimit, normalisht, llogaritet nga momenti i fillimit të procesit gjyqësor deri në momentin kur jepet vendimi dhe se në kohëzgjatjen e përgjithshme të gjykimit nuk përjashtohen vonesat e shkaktuara nga zbatimi i reformës në drejtësi, pasi barra e këtyre vonesave nuk duhet të zhvendoset te palët ndërgjyqëse (*shih vendimet nr. 46, datë 3.10.2023; nr. 6, datë 16.2.2023; nr. 13, datë 26.5.2022 të Gjykatës Kushtetuese*).

18. Në rastin konkret, Gjykata vëren se kërkesja i është drejtuar Gjykatës Administrative të Apelit me kërkesëpadi me objekt shfuqizimin e vendimit të subjektit të interesuar, KMCAP-së Epror, i cili ka përcaktuar diagnozën e vajzës së saj të mitur, duke e kategorizuar si përfituese të pagesës së aftësisë së kufizuar, grupi i parë me kujdestar. Gjykata Administrative e Shkallës së Parë Tiranë ka vendosur rrëzimin e kërkesëpadisë, vendim i cili është ankimuar nga kërkuësja. Çështja është regjistruar në Gjykatën Administrative të Apelit më datë 19.1.2022, pra aktualisht kanë kaluar 2 vjet e 3 muaj dhe ende nuk ka një vendimmarrje për të.

19. Lidhur me afatet e gjykimit të mosmarrëveshjeve administrative, Gjykata ka theksuar se neni 48 i ligjit nr. 49/2012, datë 3.5.2012 “Për gjykatat administrative dhe gjykimin e mosmarrëveshjeve administrative”, të ndryshuar



parashikon afatin 30-ditor për shqyrtimin e çështjes nga Gjykata Administrative e Apelit, ndërsa KPC-ja, me ndryshimet e vitit 2017, në grupin e rregullave për mjetet e ankimit për konstatimin e shkeljeve të gjykit brenda afatit të arsyeshëm, ka përcaktuar afatin 1-vjeçar për përfundimin e gjykit administrativ në shkallë të dytë (neni 399/2, pika 1, shkronja “a”). Kjo nënkupton se formalisht gjykimi i çështjes në Gjykatën Administrative të Apelit ka tejkaluar afatin e përcaktuar ligjor.

20. Në këtë drejtim, paraprakisht, Gjykata vlerëson të theksojë se, sikurse tashmë ka konstatuar gjatë gjykit të çështjeve që lidhen me kohëzgjatjen e paarsyeshme të afatit në parim, vonesa në gjykimin e çështjeve të individëve është pasojë e ngarkesës së lartë në gjykatat e juridiksionit të zakonshëm shkaktuar nga zbatimi i reformës në drejtësi. Gjithashtu, Gjykata ka pohuar se pavarësisht rëndësisë dhe përfitimeve që sjellin reformat në sektorin e drejtësisë, ligjvënësi ka për detyrë të marrë masat dhe të gjejë mjetet e duhura për ndryshimin e gjendjes faktike, me qëllim që ligjet të zbatohen dhe gjykatat e të gjitha niveleve të funksionojnë normalisht (*shih vendimet nr. 2, datë 17.2.2022; nr. 37, datë 5.11.2021; nr. 35, datë 1.11.2021 të Gjykatës Kushtetuese*). Gjithsesi, kjo gjendje është duke u zgjatur prej disa vitesh prandaj edhe metodat e identifikuar nga vetë gjykatat dhe KLGJ-ja, në cilësinë e organit kushtetues, që ka përgjegjësinë për të siguruar mbarëvajtjen e pushtetit gjyqësor (neni 147, pika 1, i Kushtetutës), tregojnë se mekanizmat e parashikuar nga nenet 399/1-399/12 të KPC-së i shërbejnë një kohe normale të veprimtarisë gjyqësore, pra jo situatës së jashtëzakonshme, në pikëpamje të volumit, që ndodhet tashmë sistemi i drejtësisë (*shih vendimet nr. 61 datë 20.11.2023; nr. 68, datë 7.12.2023 të Gjykatës Kushtetuese*).

21. Në këto kushte, për të vlerësuar nëse në rastin në shqyrtim ka pasur tejzgjajtje të paarsyeshme të afatit, pra nëse kërkuarës i është cenuar e drejta kushtetuese e procesit të rregullt në këtë aspekt, Gjykata do të analizojë rrethanat e veçanta të çështjes konkrete dhe kriteret e vendosura nga jurisprudenca kushtetuese që lidhen me: (i) sjelljen e kërkuarës; (ii) kompleksitetin e çështjes; (iii) sjelljen e autoriteteve; (iv) rëndësinë e asaj çfarë rrezikon kërkuarësi (*shih vendimet nr. 68, datë 7.12.2023; nr. 6, datë 16.2.2023; nr. 13, datë 26.5.2022 të Gjykatës Kushtetuese*).

22. Në lidhje me *sjelljen e kërkuarës*, Gjykata vëren se ajo, pas regjistrimit të çështjes në gjykatën e apelit më datë 19.1.2022, i është drejtuar kësaj gjykate me kërkesë për përshpejtimin e gjykit të çështjes më datë 15.2.2023. Në vijim, më datë 24.4.2023, pra pas rreth 1 viti e 3 muaj nga momenti i regjistrimit të çështjes, i është drejtuar Gjykatës së Lartë për konstatimin e shkeljes së afatit të arsyeshëm të gjykit të çështjes dhe marrjen e masave për gjykimin sa më të shpejtë, e cila ka vendosur rrëzimin e kërkesës. Sikurse pranohet edhe nga Gjykata e Lartë, nuk rezulton që çështja objekt gjykimi të jetë pezulluar, të jetë shtyrë për shkak të kërkesave të palës kërkuarëse, për sa kohë që nga regjistrimi i çështjes në Gjykatën Administrative të Apelit e deri në momentin e marrjes së vendimit nga ajo gjykatë për çështjen e kërkuarës nuk është kryer asnjë veprim procedural. Për rrjedhojë, Gjykata çmon se sjellja e kërkuarës nuk është bërë shkak për tejzgjatjen e gjykit të çështjes së saj.

23. Për sa i takon *kompleksitetin të çështjes*, Gjykata vëren se çështja ka natyrë administrative, të paditur KMCAP-në Epror dhe një kërkim në objektin e padisë, i cili në thelb lidhet me kundërshtimin e vendimit të këtij organi dhe lënien në fuqi të vendimit të KMCAP-së Niveli i parë për Paraplegji Tetraplegji dhe Neurologji Tiranë. Gjykata Administrative e Shkallës së Parë Tiranë ka vendosur rrëzimin e kërkesëpadisë. Gjykata Administrative e Apelit është vënë në lëvizje për ankimin e kërkuarës. Sikurse thekson edhe Gjykata e Lartë në vendimin për rrëzimin e kërkesës për konstatimin e tejzgjatjes së gjykit të çështjes dhe përshpejtimin, çështja nuk paraqitet komplekse, pasi ka të bëjë me shpërblimin e dëmit pasuror dhe moral (jopasuror), si dhe shpenzimet e nevojshme në favor të kërkuarës si pasojë e dëmit të shkaktuar nga mjekimi i pakujdesshëm.

24. Për sa i përket *sjelljes së autoriteteve*, duke mbajtur në konsideratë sa është theksuar më sipër për situatën aktuale të ngarkesës së sistemit gjyqësor (*shih paragrafin 20 të vendimit*), Gjykata vëren se çështja e kërkuarës është në pritje për shqyrtim në Gjykatën Administrative të Apelit tashmë prej 2 vjetësh e 3 muajsh, ndërsa kohëzgjatja totale e procedurave nga momenti i paraqitjes së padisë në gjykatën e shkallës së parë është 2 vjet e 7 muaj. Nga të dhënat e marra nga Gjykata Administrative e Apelit (*shih paragrafin 5 të vendimit*), si dhe sikurse arsyeton Kolegji Administrativ i Gjykatës së Lartë në vendimin për



rrezimin e kërkesës së saj për konstatimin e tejzgjatjes së gjykimit dhe përsheptimin e procedurave, gjykata e apelit është në pamundësi objektive për të gjykuar çështjen e kërkesës brenda afatit të arsyeshëm, për shkak të ngarkesës së madhe dhe jo për shkaqe subjektive që lidhen me vlerësime dhe qëndrime abuzive të gjyqtarit. Prandaj, në analizë të sa më sipër, Gjykata vlerëson se kohëzgjatja e gjykimit të çështjes së kërkesës lidhet me ngarkesën e lartë në Gjykatën Administrative të Apelit dhe të gjyqtarit relator, shkaktuar nga zbatimi i reformës në drejtësi.

25. Së fundmi, në lidhje me *rëndësinë e asaj çfarë rrezikon kërkesë*, Gjykata konstaton se pas kryerjes së vizitës dhe vlerësimit të dokumentacionit mjekësor, si dhe ekzaminimeve përkatëse, KMCAP-ja Epror ka vendosur që vajza e kërkesës nuk përfiton statusin e paraplegjikut, por kalon si përfutuese e pagesës së aftësisë së kufizuar, grupi i parë me kujdestar. Ky vlerësim i KMCAP-së Epror është lënë në fuqi nga Gjykata Administrative e Shkallës së Parë Tiranë, vendimi i së cilës është ankimuar nga kërkesja, por nuk është gjykuar ende nga Gjykata Administrative e Apelit.

26. Për të analizuar këtë kriter, Gjykata i është drejtuar kërkesës për paraqitjen e arsyeve dhe shkaqeve se përse gjykimi i çështjes së saj duhej të kryhej me prioritet në Gjykatën Administrative të Apelit. Me shkresën e datës 29.04.2024 kërkesja ka parashtruar se tejzgjatja e procedurave rrezikon në mënyrë të konsiderueshme interesin e vajzës së saj të mitur, e cila ka humbur të drejtën për t'u trajtuar me përfitimet që i takojnë prej muajit qershor 2021, duke përkeqësuar edhe më tej gjendjen e saj shëndetësore dhe sociale. Gjithashtu, sipas kërkesës, ajo dhe vajza e saj e mitur ndodhen në kushte të vështira socioekonomike.

27. Edhe Gjykata Evropiane për të Drejtat e Njeriut (GJEDNJ) ka parashikuar listën e çështjeve të cilat kërkojnë “kujdes të veçantë” ose “kujdes të jashtëzakonshëm”, të tilla, si ato që lidhen me statusin civil, kujdestarinë e fëmijëve, marrëdhëniet e punësimit, sëmundjet e pashërueshme, pensionin (veçanërisht pensionin e invaliditetit) etj. Në një çështje, në të cilën kërkesit pretenduan se autoritetet nuk kishin përlogaritur në mënyrën e duhur pensionin e invaliditetit, GJEDNJ-ja ka vlerësuar se shumica përbënte një pjesë të rëndësishme të pensionit dhe se ai ishte burimi kryesor i të ardhurave, rrjedhimisht autoritetet duhej

ta kishin trajtuar çështjen me kujdes të veçantë (*shih Gorokhov dhe Rusyayev kundër Rusisë, datë 17.3.2005, § 34*). Gjithashtu, GJEDNJ-ja ka konstatuar cenimin e së drejtës për gjykim brenda afatit të arsyeshëm edhe në një rast tjetër, pasi ka vlerësuar se procesi gjyqësor i vënë në lëvizje nga kërkesi lidhej me mjetet e jetesës, ndonëse ai përfitonte një shumë të zvogëluar të pensionit të invaliditetit (*shih Bielinski kundër Polonisë, datë 21.7.2022, § 48*). Të njëjtin qëndrim GJEDNJ-ja ka mbajtur edhe kur qëllimi i procesit gjyqësor ka qenë në thelb përmirësimi i situatës së kërkesit, në kushtet kur pensioni i invaliditetit përbënte të ardhurën kryesore të tij (*shih Mocie kundër Francës, datë 8.4.2003, § 22*).

28. Për sa më lart, Gjykata vlerëson se çështja e kërkesës, për shkak të natyrës së saj, e cila lidhet me interesa “vetjakë e jetësorë”, ku përfshihen edhe interesat e fëmijës së saj të mitur, e cila është me aftësi ndryshe, kërkon nga gjykatat shqyrtimin me përparësi të çështjes, veçanërisht kur objekti i mosmarrëveshjes ka të bëjë me pretendime financiare. Në këtë rast, Gjykata mban parasysh dhe vë në dukje se kërkesja ka pretenduar se ndodhet në kushte të vështira ekonomike, si dhe faktin se interesi i fëmijës së mitur për të gëzuar jetë cilësore të shëndetshme përbën prioritet parësor për çdo institucion, veçanërisht për autoritetet vendimmarrëse me ndikim të drejtpërdrejtë në përkuajdesen dhe mirëqenien e tyre. Duke mbajtur në konsideratë faktin se nga momenti i regjistrimit të kërkesëpadisë kanë kaluar pothuajse tre vjet, ngarkesa me të cilën përballet sistemi i drejtësisë nuk mund të konsiderohet një argument thelbësor për vonesën në gjykimin e saj, për më tepër, kur objekt i gjykimit janë detyrimet ndaj fëmijës së mitur. Gjykata çmon se Gjykata e Lartë e ka analizuar çështjen vetëm në drejtim të kompleksitetit të saj dhe jo të rëndësisë së asaj çfarë rrezikon kërkesja, si një aspekt i rëndësishëm i vlerësimit të kohëzgjatjes së arsyeshme të gjykimit. Në këtë drejtim, ajo duhet të mbante në konsideratë faktin se pretendimet me natyrë financiare të kërkesës kanë për qëllim mbulimin e shpenzimeve për sëmundjen dhe trajtimin e vajzës së saj të mitur.

29. Nisur nga sa më lart, në vlerësim të analizës së standardeve të mësipërme, Gjykata çmon se në rrethanat e rastit konkret kohëzgjatja e shqyrtimit të çështjes së kërkesës në Gjykatën Administrative të Apelit në raport me rëndësinë e asaj çfarë rrezikon kërkesja ka tejkaluar një kufi kohor të arsyeshëm në



aspektin kushtetues. Gjykata vlerëson, gjithashtu, se vlerësimi i kryer nga Gjykata e Lartë nuk është në përputhje me Kushtetutën, për rrjedhojë vendimi i saj për rrëzimin e kërkesës për përshpejtimin e procedurave duhet të shfuqizohet dhe gjykimi i ankimit të kërkuës nga Gjykata Administrative e Apelit duhet të përshpejtohet. Për këtë qëllim, bazuar në nenin 81, pika 3, të ligjit nr. 8577/2000, Gjykata çmon të caktojë afatin 6-mujor, brenda të cilit duhet të veprojë Gjykata Administrative e Apelit, duke e konsideruar këtë afat të arsyeshëm në raport me të drejtën kushtetuese të kërkuës. Për rrjedhojë, kërkesa duhet të pranohet.

PËR KËTO ARSYE,

Gjykata Kushtetuese, në mbështetje të neneve 131, pika 1, shkronja “P” dhe 134, pika 1, shkronja “I”, të Kushtetutës, si dhe nenit 72, të ligjit nr. 8577, datë 10.2.2000, “Për organizimin dhe funksionimin e Gjykatës Kushtetuese të Republikës së Shqipërisë”, të ndryshuar, njëzëri,

VENDOSI:

1. Pranimin e kërkesës.
2. Shfuqizimin e vendimit nr. 00-2023-2304, datë 6.6.2023 të Kolegjit Administrativ të Gjykatës së Lartë.

3. Konstatimin e cenimit të afatit të arsyeshëm të gjykimit të çështjes administrative nr. 31155-00075-86-2022, me datë regjistrimi 19.1.2022.

4. Detyrimin e Gjykatës Administrative të Apelit që të gjykojë çështjen brenda një afati 6-mujor nga hyrja në fuqi e këtij vendimi.

Ky vendim është përfundimtar dhe hyn në fuqi ditën e botimit në Fletoren Zyrtare.

Marrë, më 7.5.2024.

Shpallur, më 4.6.2024.

Kryetare: Holta Zaçaj

Anëtarë: Fiona Papajorgji, Marsida Xhaferllari, Ilir Toska, Sandër Beci, Elsa Toska, Sonila Bejtja, Marjana Semini, Genti Ibrahim

KËRKESË

Shtetasja Eda Bruzja kërkon, pranë Gjykatës së Rrethit Gjyqësor Tiranë, shpalljen e vdekjes së shtetasit Fatmir Bruzja, me atësi Riza dhe amësi Manushaqe, i datëlindjes 31.8.1968, lindur në Vlorë, dhe me vendbanim të fundit në Njësinë Bashkiake nr.10, Bashkia Tiranë.

KËRKUESE
Eda Bruzja

Formati 61x86/8

Shtypshkronja e Qendrës së Botimeve Zyrtare
Tiranë, 2024

Adresa: Rr. "Nikolla Jorga", Tiranë
Tel./fax: +355 4 24 27 004 Tel.: +355 4 24 27 006



Çmimi 144 lekë